

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6110
E enjte, 10 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Senati i UP-së miraton vendimin për pranimin e studentëve të rinj



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PAS KTHIMIT NGA BRUKSELI, KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI KA MBAJTUR MBLEDHJEN E KABINETIT QEVERTAR

HOTI: MARRËVESHJA NË UASHINGTON, HAP I MADH DREJT NJOHJES RECIPROKE



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije të mërkurën se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë

është një hap drejt arritjes së marrëveshjes së gjithanshme finale me Serbinë. Në një konferencë për media, Hoti ka vlerësuar se marrëveshja e 4

shtatorit ka fuqizuar sovranitetin e Republikës së Kosovës. Ai ka treguar se qeveria do të përgatisë plan veprimi për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit

Nagavci: Zgjedhjet e reja duhet të mbahen sa më parë



Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, u ka bërë thirrje deputetëve të opozitës dhe atyre brenda koalicionit qeverisës, që t'i japin nënshkrimet për mocionin e shkarkimit të qeverisë Hoti. Në një konferencë për media, Nagavci ka theksuar se kjo qeveri e paligjshme duhet të shkarkohet dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja. "Kjo qeveri duhet të shkojë. Zgjedhjet e reja demokratike duhet të organizohen sa më parë. Nuk mund të sjellë marrëveshje e aranzhime të mira një qeveri pa legjitimitet e me zyrtarë që japin zotime që s'i mbajnë", ka thënë ajo

Pesë mijë hektarë tokë bujqësore futen nën sistem të ujitjes



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepgjishit - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

TË GJITHË PËR GRENELLIN, TË GJITHË KUNDËR GRENELLIT! F. 11

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE

QEVERTIA E RE NË MAL TË ZI NUK DO TA TËRHEQË NJOHJEN E KOSOVËS F. 2

PËR 24 ORË, GJASHTË VIKTIMA DHE 76 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

EKONOMI

TETËMBËDHJETË KANDIDATË NË GARË PËR DREJTOR TË DOGANËS F. 8

GASTRONOMËT KËRKOJNË ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS F. 8



KULTURË

DUMOSHI: SYNIMI IM, FINALIZIMI I OBJEKTIT TË TEATRIT TË OPERËS DHE BALETIT F. 6

SPORT

KOK-u KËRKON NGA QEVERTIA LEJIMIN E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE SPORTIVE F. 16

Ahmeti takon Dedajn, vlerëson arritjen e marrëveshjes në Uashington

SHKUP, 9 SHTATOR (ER) - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, të mërkurën në selinë e partisë në Tetovë, ka takuar ambasadorin e Republikës së Kosovës, Gjergj Dedaj. Ahmeti gjatë takimit e njoftoi ambasadorin Dedaj me situatën aktuale në vend si dhe shqyrtuan ngjarjet e rëndësishme që prekin të dyja vendet.

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, gjatë takimit me ambasadorin

e Kosovës, Dedaj, diskutuan edhe për rrjedhën e bisedimeve për formimin e shumicës parlamentare dhe me këtë, edhe të qeverisë së re. Ahmeti tha se në këtë garniturë qeveritare shqiptarët e Maqedonisë së Veriut janë faktorizuar edhe më shumë.

Ahmeti e përgëzoi Gjergj Dedaj për marrëveshjen e arritur në Uashington mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Ahmeti këtë marrëveshje e

cilësoi si të mirë dhe në dobi të shqiptarëve të Kosovës, pasi që ajo është edhe një hap para drejt marrëveshjes finale, njohjen e ndërsjellë mes dy shteteve. Ahmeti gjithashtu e njoftoi Dedajn se shumë shpejt do të tejkalohet problemi me qytetarët e Kosovës të cilët kalojnë transit nëpër Maqedoni të Veriut apo shfrytëzojnë aeroportin e Shkupit dhe atë të Ohrit për t'u kthyer në vendlindje.



Qeveria e re në Mal të Zi nuk do ta tërheqë njohjen e Kosovës

"Epoka e re"

PODGORICE, 9 SHTATOR - Liderët e tri subjekteve politike të koalicionit opozitar, të cilat e kanë fituar shumicën në zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi, të mbajtura më 30 gusht, në një konferencë për media të mërkurën, kanë prezantuar parimet mbi të cilat do të mbështetet qeveria e ardhshme dhe të cilat nënkuptojnë bashkëpunimin me aleancën e NATO-s, mosvënien në diskutim të njohjes së Kosovës dhe që përjashtojnë mundësinë e ndryshimit të simboleve shtetërore të Malit të Zi.

Parimet e marrëveshjes, të cilat janë përafuar nga liderët e koalicionit "Për ardhmërinë e Malit të Zi", "Paqja është kombi ynë" dhe "E zeza mbi të bardhë" e Zdravko Krivokapiqit, Aleksa Beçiqit dhe Dritan Avazoviqit, kanë deklaruar që Qeveria e re e



Malit të Zi: 1. Në mënyrë të përgjegjshme do t'i zbatojë të gjitha obligimet ndërkombëtare që i ka marrë mbi vete shteti, do ta forcojë bashkëpunimin me NATO-n dhe me përkushtim do t'i

zbatojë të gjitha reformat e nevojshme për anëtarësim të plotë të Malit të Zi në Bashkimin Evropian; 2. Do t'i depolitizojë plotësisht institucionet kyçe qeveritare, me qëllim të luftës së

pakompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; 3. Do ta respektojë Kushtetutën e Malit të Zi dhe nuk do të nisë nisma që kanë për qëllim ndryshimin e flamurit, stemës dhe himnit të shtetit; 4. Nuk do

të nisë procedurë për tërheqjen e pranimin të pavarësisë së Kosovës; 5. Nuk do të hakmerret mbi baza politike apo çfarëdo baze tjetër; 6. Do të miratojë dhe rishikojë të gjitha ligjet në përputhje me standardet evropiane, me qëllim të integritimit sa më të shpejtë të Malit të Zi në BE; 7. Do t'iu mundësojë partive të pakicave pjesëmarrjen në qeveri, pavarësisht se a kanë apo jo status parlamentar.

Sipas rezultateve preliminare të Komisionit Zgjedhor Shtetëror, tri koalicionet opozitare kanë fituar 41 mandate. "E zeza mbi të bardhë" në krye me Aksionin e Bashkuar për Reformën (URA) të Dritan Avazoviqit ka marrë katër mandate, "Për të ardhmen e Malit të Zi" në krye me Frontin Demokratik ka marrë 27 mandate dhe "Paqja është kombi ynë" e Aleksa Beçiqit ka marrë dhjetë ulëse në parlament.

Presidenca trepalëshe e Bosnje-Hercegovinës diskuton më 17 shtator kërkesën për njohjen e Kosovës

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Anëtarët e presidencës trepalëshe të Bosnje-Hercegovinës kanë vendosur që t'i mbajnë dy seanca të jashtëzakonshme më 17 shtator, në të cilat do të diskutohet çështja e njohjes së Kosovës dhe zhvendosjes së Ambasadës së Bosnjës nga Tel Avivi në Jerusalem.

Kërkesa për ta shqyrtuar

njohjen e Kosovës është bërë nga anëtari i presidencës, Zelko Komshiq dhe tjetra për zhvendosjen e ambasadës nga anëtari tjetër i presidencës, Millorad Dodik. Javën e kaluar, Serbia, në kuadër të një marrëveshjeje me Kosovën, të nënshkruar në Uashington, ka rënë dakord për zhvendosjen e ambasadës së vet nga Tel

Avivi në Jerusalem.

Presidenca e Bosnje-Hercegovinës mbajti konsultime të mërkurën, po ashtu vendosi që seanca e rregullt e Presidencës do të mbahet më 17 shtator, në të cilën do të diskutohet kërkesa e anëtarit të presidencës, Millorad Dodik, për t'u bashkuar me nismën "mini-Shengen".



Dosje të Gjykatës Speciale apo frikësim dëshmitarësh?

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Dëshmitarët potencialë të proceseve gjyqësore ndaj ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mund të ndihen të frikësuar pas publikimit të informacioneve se Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së ka në pronësi dosje të Gjykatës Speciale (Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Prokurorisë në Hagë). Kështu vlerësojnë njohësit e fushës së drejtësisë në Kosovë.

Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së të hënën në një konferencë pretendoi se ka mbi 4 000 dosje të Gjykatës Speciale, pasi i ato ishin dorëzuar në mënyrë anonime zyrës së kësaj organizate. Veteranët thanë se në këto dokumente janë emrat dhe adresat e dëshmitarëve dhe personave të tjerë me të cilët kanë bashkëpunuar hetuesit e Gjykatës Speciale.

Por, gjatë të martës, ndonëse nuk është konfirmuar nga Gjykata Speciale, hetuesit e gjykatës kanë shkruar në zyrën e OVL të UÇK-së në Prishtinë. Përfaqësues të kësaj organizate kanë konfirmuar për media në Kosovë se atyre u është dorëzuar një kopje e këtyre dokumenteve.

Përmbajtja e këtyre dokumenteve të pretenduara është e panjohur dhe nuk dihet ende nëse ato janë origjinale. "Radio Evropa e Lirë" ka dërguar disa pyetje të zëdhënësja e Dhomave të Specializuara, Angela Griep. Në një përgjigje të shkurtër, Griep, ka thënë se "nuk kemi asnjë koment për të bërë".

Njëjtë është përgjigjur edhe zëdhënësi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, Christopher

Bennett, duke thënë se "Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk është duke komentuar këtë çështje".

Betim Musliu nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se bërja publike e dokumenteve të tilla vë në rrezik të gjithë ata persona që mund të jenë të përfshirë në procese eventuale gjyqësore. "Kjo është një formë e drejtpërdrejtë e frikësimit dhe kërcënimit të të gjithë atyre personave që mund të jenë në çfarëdo forme subjekte të procedurave pranë Gjykatës Speciale", thotë Musliu.

Edhe drejtuesi i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Bekim Blakaj, thotë se mënyra se si u prezantuan këto dokumente nga zyrtarët e OVL të UÇK-së, lë të kuptohet se qëllimi kryesor është të frikësohen dëshmitarët. "Theksi u vendos më shumë në dëshmitarë që t'ua bëjnë me dije se e dinë se kush janë ata dhe se i dinë edhe adresat [e tyre]. Po besoj se ishte një mënyrë për t'i frikësuar dëshmitarët, por gjithsesi për të komprometuar dhe për t'ia ulur edhe më shumë imazhin në Kosovë, Dhomave të Specializuara", thotë Blakaj.

Betim Musliu nga Instituti i Kosovës për Drejtësi thotë se duhet të ndodhë një hetim për mënyrën sesi këto dokumente kanë arritur tek Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Musliu thotë që në rast se konfirmohet se janë dokumente zyrtare të Gjykatës Speciale, atëherë duhet ndjekur penalisht personat përgjegjës që kanë për qëllim komprometimin e këtij institucioni. "Është e papranueshme, sidomos për faktin se po ndodh në kohën kur kjo gjykatë është duke zhvilluar procedura, ka aktakuza të



ngritura nga prokuroria e të cilat është duke i shqyrtuar dhe kjo përbën një rrezik dhe përbën një tendencë për ta komprometuar në tërësi punën e Gjykatës Speciale", thotë Musliu.

Nga ana tjetër, Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare thotë se Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka manipuluar opinionin në momentin që ka dalë me njoftimin se ka rreth 4 000 dosje me të dhënat e dëshmitarëve potencialë që pritet të dëshmojnë në procese gjyqësore kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së. "Për fat të keq me vite është duke u përmendur në radhë të parë prej komunitetit ndërkombëtar dhe prej palës serbe se në Kosovë dëshmitarët po frikësohen, po ndikohet në ta, po shantazhohen. Madje kanë shkruar aq larg sa që kanë thënë se edhe po vriten. E tash ky veprim i djeshëm i këtyre veteranëve në njëfarë mënyre po i konfirmon këto lloj

pohimesh", thotë Blakaj.

Që nga krijimi i Gjykatës Speciale të Kosovës, ekspertët e kanë parë si sfidë të vështirë mbrojtjen e dëshmitarëve. Një nga arsyt kryesore pse Gjykata Speciale e Kosovës u vendos në Hagë ishte frika nga kërcënimi i dëshmitarëve potencialë "marrë parasysh se bëhet fjalë për çështje të ndjeshme dhe për faktin se disa nga të dyshuarit, në pjesë të caktuara të shoqërisë së Kosovës, mund të konsiderohen si luftëtarë të lirisë", thuhet në komunikatën e Qeverisë së Holandës, të lëshuar qysh në vitin 2016, kur ishte vendosur për këtë gjykatë.

Dhomat e Veçanta apo siç njihet në Kosovë, Gjykata Speciale, është gjykata e katërt me radhë që merret me hetimin e krimeve të supozuara të luftës të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto krime paraprakisht i kanë hetuar dhe gjykuar, Gjykata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë apo UNMIK-u,

Tribunali Ndërkombëtar i Hagës si dhe Gjykata e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX. Deri më tani Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim qindra ish-pjesëtarë të UÇK-së, qoftë si dëshmitarë apo si të dyshuar.

Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka njoftuar se më 24 prill ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër presidentit Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë. Deri më tani asnjë aktakuzë nuk është konfirmuar ose hedhur poshtë publikisht. Gjyqtari ka gjashtë muaj për të konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzën. Nën përgjegjësinë e Gjykatës Speciale është hetimi i krimeve të pretenduara kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe veprave të tjera penale në lidhje me pretendimet e përfshira në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011.

Senati i UP-së miraton vendimin për pranimin e studentëve të rinj

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Kryesuesi i Senatit i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Bujar Dugolli, ka bërë me dije se është miratuar konkursi për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2020/2021. Ai ka thënë se për mënyrën e aplikimit kandidatët për studentë të rinj do të njoftohen me kohë. "Maturantët që sapo kanë diplomuar dhe të gjithë të interesuarit e tjerë edhe jashtë Kosovës kanë këtë mundësi të jashtëzakonshme, që rrugën e tyre drejt karrierës ta vazhdojnë në ndonjërin nga trembëdhjetë fakultetet tona, që numërojnë dhjetëra



programe dhe specializime. Kandidatët për studentë do të kenë shumë oferta, shumë kolegje e universitete të tjera, por asnjëri nuk mund t'i afrohet cilësisë së universitetit

tonë, pavarësisht prej përpjekjeve të çdollojshme për ta penguar UP-në si nga brenda, po ashtu edhe nga jashtë tij", ka thënë Dugolli. Sipas tij, Fakulteti Filozofik, në

tetë drejtimet e tij të akredituara (BA: Histori, Filozofi, Sociologji, Psikologji, Shkenca Politike, Puna sociale, Antropologji kulturore dhe Arkeologji), do të pranojë 620

studentë, 180 studentë në studimet master - MA dhe pesë studentë në studimet e doktoraturës - PhD, numër ky i miratuar nga Senati i Universitetit, ndërsa mënyra e aplikimit, koha dhe vendi, të gjitha do të jenë të detajuara në njoftimin që do të publikohet në faqen elektronike të fakultetit sapa të miratohet konkursi nga MASH-t-i. "Universiteti i Prishtinës dhe studentët e tij kanë bërë revolucion në shoqërinë tonë duke u bërë gurthemeli i shtetit të Kosovës. Universiteti i Prishtinës është krenaria e Kosovës. Sukseset!", ka thënë Dugolli.



PAS KTHIMIT NGA BRUKSELI, KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI
KA MBAJTUR MBLEDHJEN E KABINETIT QEVERTAR

HOTI: MARRËVESHJA E UASHINGTONIT, HAP I MADH DREJT NJOHJES RECIPROKE

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije të mërkurën, se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike me Serbinë është një hap drejt arritjes së marrëveshjes së gjithanshme finale me Serbinë. Në një konferencë për media, Hoti ka vlerësuar se marrëveshja e 4 shtatorit ka fuqizuar sovranitetin e Republikës së Kosovës. Ai ka treguar se qeveria do të përgatisë plan veprimi për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit

lidh Prishtinën me Detin Adriatik, mbështetje financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, investime në energjetikë përmes sjelljes së gazit në Prishtinë, termocentrale me gaz dhe rrjetin e shpërndarjes së gazit në Kosovë”, është shprehur Hoti. Sipas tij, këto projekte do të mbështeten nga Korporata Ndërkombëtare Financiare Zhvillimore e Shteteve të Bashkuara (DFC) dhe Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit të Qeverisë së ShBA-së (MCC).

Ai ka treguar se ShBA-ja është e interesuar që këto projekte të fillojnë të zbatohen menjëherë. Gjatë javës së ardhshme, sipas tij, do të përgatitet një plan veprimi për detyrat e institucioneve të Kosovës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, që pritet të shqyrtohet nga qeveria në mbledhjen e ardhshme.

Njohja nga Izraeli tregon se sovraniteti i Kosovës nuk është prekur

Kryeministri Hoti ka treguar arsyet pse është e rëndësishme për Kosovën njohja nga Izraeli. “Është një njohje tepër e rëndësishme për shtetin e Kosovës. Çdo njohje është e rëndësishme pa dyshim, por janë

disa që janë vërtet të rëndësishme për shkak të sinjalit që dërgojnë. Kjo është njohja e parë ndoshta në tre vjetët e fundit, që nënkupton se është thyer ai trendi negativ i njohjeve ndërkombëtare për shtetin e Kosovës”, ka deklaruar Hoti. Sipas tij, dyshimet se në këtë marrëveshje është shkelur integriteti territorial i Kosovës i largon njohja nga Izraeli. “Kushdo që ka dyshime se kjo marrëveshje e cenon sovranitetin e Kosovës, unë besoj se kjo pikë e marrëveshjes, kjo njohje që ka arritur 22 minuta pas nënshkrimit të marrëveshjes në Zyrën Ovale, e nxjerrë që e ka gabim, sepse me këtë marrëveshje fuqizohet sovraniteti i shtetit të Kosovës, e nuk dobësohet”, ka thënë Hoti. I pari i qeverisë ka treguar se Uashingtoni dhe Brukseli janë në koordinim të plotë për procesin e dialogut. “Jo vetëm që ka koordinim të ngushtë në procesin e dialogut në mes të Brukselit dhe Uashingtonit, por ka koordinim të plotë në këtë proces. Dhe kjo neve na jep siguri që të ecim përpara në këtë proces pa u hamendur fare, duke e ditur që ne do të shkojmë drejt një marrëveshje përfundimtare për normalizim të plotë të marrëdhënieve për njohje reciproke dhe për stabilizim të

plotë të rajonit dhe integritet të plotë euroatlantik”, ka thënë Hoti. Më tutje, ai ka folur edhe për pikën e marrëveshjes ku flitet për futjen e Kosovës në mini-shengenin. “Unë kam qenë kundër për mini-shengenin, por kjo më është kërkuar në Uashington që të pranojmë këtë pjesë të marrëveshjes dhe unë e kam pranuar”, ka deklaruar Hoti, duke folur edhe për pikën që flitet për Ujmanin. “Pika e marrëveshjes për Ujmanin është e pandryshueshme sepse do të bëhet një studim i fizibilitetit nga Amerika dhe do të dihet se si do të përdoret. Pika e dhjetë që po referohet në media nuk qëndron dhe nuk besoj se dikush që ka qëndruar në Prishtinë mund të ketë më shumë informacion se ne që kemi qenë atje”, ka deklaruar ai.

Kryeministri Hoti ka komentuar edhe kritikën e partnerit kryesor të koalicionit qeverisës, AAK-së. “Kur unë kryesoj delegacionin përfaqësues qeverinë, pra edhe AAK-në edhe Nismën si dhe partnerët e tjerë të koalicionit. AAK-ja është e përfaqësuar përmes meje në procesin e dialogut”, ka thënë Hoti. Ai ka vlerësuar se që nga shpallja e pavarësisë Kosova nuk ka pasur asnjëherë vëmendjen kaq të madhe.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se marrëveshja e Uashingtonit është një hap i madh në drejtim të njohjes reciproke në mes të dy shteteve. Pas kthimit nga Brukseli, ai ka mbajtur mbledhjen e kabinetit qeveritar, në të cilën i ka njoftuar ministrat për vizitën në Uashington dhe në Bruksel, si dhe për takimet e zhvilluara atje. Ai ka deklaruar se marrëveshja e 4 shtatorit e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë ka fuqizuar sovranitetin e Republikës së Kosovës. “Marrëveshja e arritur në Uashington është hap tepër i

madh, hap i jashtëzakonshëm drejt marrëveshjes finale për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë që nënkupton njohje reciproke në mes të dy vendeve”, ka deklaruar Hoti në një konferencë për media pas mbledhjes së qeverisë. Ai ka treguar se shtylla kryesore e kësaj marrëveshjeje është ajo ekonomike. “E para është pjesa ekonomike, janë projektet infrastrukturorë, të dizajnuara kryesisht nga Ministria e Infrastruktura dhe ajo e Ekonomisë dhe Ambientit, që në total shkojnë në një miliard dollarë investime, e që përfshijnë: autostradën Prishtinë-Merdare, hekurudhën Prishtinë-Merdare, studimin e fizibilitetit për hekurudhën që e



Kryeministri Hoti ka folur edhe për takimin e nivelit të lartë në Bruksel që ka pasur me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se ky takim ka qenë në shërbim ta draftimit të marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Nuk bisedohet në asnjë tavolinë për integritetin dhe sovranitetin shtetëror të Kosovës. Bisedohet vetëm për marrëveshjen finale për njohjen reciproke", ka theksuar Hoti. Ai ka vlerësuar se ndihet mirë që me qeverisjen e tij e ka kthyer Kosovën aty ku e ka vendin. "Janë të rëndësishme tepër të madhe dhe ndihem i kënaqur që brenda 3 muajve të qeverisjes sonë kemi arritur t'i konsolidojmë miqësitë e dëmtuara për një kohë dhe të

kthehemi aty ku e kemi vendin, pranë partnerëve tanë", ka thënë Hoti, duke shtuar se për këto takime do të raportojë edhe në Kuvendin e Kosovës.

Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 4 shtator, në Shtëpinë e Bardhë, në prani të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, kanë nënshkruar marrëveshjen për normalizimin ekonomik, e cila ka 16 pika. Palët nuk i kanë hedhur nënshkrimet në dokumentin e njëjtë, por secila veç e veç i ka nënshkruar zotimet e tyre. Njëkohësisht, presidenti Trump ka nënshkruar një letër, përmes së cilës i ka përgëzuar palët për guximin lidhur me arritjen e përparimit në normalizimin e marrëdhënieve.

Qeveria miraton ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2019

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj ka miratuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2019, pjesa e dytë, objektivi 1, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ky projektligj trajton çështjen e ratifikimit të marrëveshjes financiare për IPA 2019, pjesa e dytë, objektivi 1, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje bëhet edhe miratimi i programit vjetor IPA 2019, pjesa e dytë, objektivi 1, me anë të të cilit do të zbatohet asistencë e dhënë nga BE-ja për Kosovën në kuadër të IPA-s në formë të

projekteve të përshkruara në kuadër të marrëveshjes në fjalë. Kjo është në përputhje të plotë me prioritetet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023.

Në këtë mbledhje është miratuar edhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes kornizë për kredi ndërmjet bankës për zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - instrumenti për financim të sektorit publik për reagim emergjent ndaj Covid-19. Gjithashtu, është miratuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për deminim humanitar.

Nagavci: Zgjedhjet e reja duhet të mbahen sa më parë

Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, u ka bërë thirrje deputetëve të opozitës dhe atyre brenda koalicionit qeverisës, që t'i japin nënshkrimet për mocionin e shkarkimit të qeverisë Hoti. Në një konferencë për media, Nagavci ka theksuar se kjo qeveri e paligjshme duhet të shkarkohet dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja. "Kjo qeveri duhet të shkojë. Zgjedhjet e reja demokratike duhet të organizohen sa më parë. Nuk mund të sjellë marrëveshje dhe aranzhime të mira një qeveri pa legjitimitet e me zyrtarë që japin zotime që s'i mbajnë", ka thënë ajo

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Në ambientin e jashtëm të Kuvendit të Kosovës, të mërkurën, nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka folur për zhvillimet e fundit në vend. Nagavci e filloi konferencën me një rikujtim të kërkesave që ka bërë LV-ja për raportim të kryeministrit Hoti në Kuvend për, siç thuhet, "në lidhje me zotimet dhe koncesionet e tij ndaj Serbisë dhe kërkesës për raportim në komisionet si ai i punëve të jashtme dhe diasporë; ekonomi, punësim, tregti, industri, ndërmarrësi dhe investime strategjike; të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, dhe në komisionin për mbikëqyrje të financave publike".

Nagavci ka theksuar se një kryeministër që ka mandat të kontestuar në Gjykatën Kushtetuese, te qytetarët, e që nuk gëzon mbështetjen as brenda koalicionit të tij qeverisës, nuk mund të bëjë zotime e koncesione në emër të Republikës së Kosovës. Ajo ka thënë se qeveria e paligjshme Hoti, pas heqjes dorë nga reciprociteti, e tani edhe nga

aplikimi për anëtarësim të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare, sa për t'u dhënë hapësirë bisedimeve, përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës. "Kjo gjë nuk i lejohet asnjë individ, aq më pak këtij kryeministri pa legjitimitet. Madje kjo gjë nuk mund të bëhet as nga Kuvendi sepse nuk mund të hiqet dorë nga vetja. Kjo është e barasvlershme me sovranitetin dhe vetë qenien e Republikës. Ky është pezullim i Republikës. Kjo pikë e ujdisë Thaçi - Vuçiq prek shumë dimensione të jetës, vetëm në fushën e arsimit kjo nënkupton se ne nuk do të aplikojmë në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), nga ku buron vlefshmëria e diplomave të fëmijëve tanë", ka thënë ajo.

Duke sjellë në vëmendje deklaratat e Hotit në Kuvendin e Republikës që platformë e vetme në bisedime do të jetë Kushtetuta, dhe deklaratat e tjera të tij kundër minishengenit dhe kundër dhënies së resurseve të Kosovës, nënkryetarja Nagavci kujtoi sërish se të gjitha këto i hodhi poshtë kryeministri i paligjshëm Hoti, i cili, sipas saj, lëre se nuk përmendi njohje të Kosovës, por edhe emrin

republikë e hoqi nga dokumenti i nënshkruar në Uashington.

Nagavci u bëri thirrje partive opozitare dhe deputetëve brenda koalicionit qeverisës që janë të pakënaqur me avazin e dëmshëm e të rrezikshëm të kësaj qeverie të paligjshme në Uashington e Bruksel, që t'i japin nënshkrimet për mocionin e shkarkimit të saj. "Ata mund ta japin nënshkrimin për mocionin e mosbesimit ndaj kësaj qeverie. Nëse hezitojnë akoma ta nënshkruajnë atë, ata faktikisht as nuk mund të konsiderohen si opozitë e janë përgjegjës po aq sa Hoti dhe kjo qeveri", ka thënë Nagavci.

Ajo ka thënë se presin që të hënën të caktohet sa më parë seanca e radhës ku kryeministri Hoti do të ballafaqohet me deklaratat e tij kundërthënëse, me veprimet që bien ndesh me zotimet që ka bërë para deputetëve jo më larg se në qershor e korrik të këtij viti. "Kjo qeveri duhet të shkojë. Zgjedhjet e reja demokratike duhet të organizohen sa më parë. Nuk mund të sjellë marrëveshje e aranzhime të mira një qeveri pa legjitimitet e me zyrtarë që japin zotime që s'i mbajnë, e që gënjejnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka theksuar Nagavci.



Gjilani shpërblehet me grant prej 745 mijë eurosh për performancën e vitit 2019

GJILAN, 9 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjilanit është shpërblyer me grant nga Ministria e Pushtetit Lokal në shumën prej 745 mijë eurosh për performancën e vitit 2019. Në këtë mënyrë, Gjilani zë vendin e tretë në nivel të Kosovës për shumën më të madhe të grantit të fituar. Kreu i Komunës, Lutfi Haziri, ka falënderuar MPL-në për vlerësimin e lartë për Gjilanin, kurse ka përgëzuar ekipin e madh të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) për

angazhimin dhe profesionalizimin e madh që ka treguar në këtë aspekt. "Jam shumë i nderuar që Gjilani është radhitur në krye për performancën e lartë nga MPL-ja dhe partnerët: SDC/Zyra Zvicerane, Suedia dhe Norvegjia. Ky është një vlerësim i jashtëzakonshëm për Gjilanin. Këto mjete nga granti, sikur edhe ato të kaluarat, do të shpenzohen për investime komunitare. Faleminderit ekipit të madh të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale për

punën e madhe që e ka bërë, edhe të gjithë resorëve të komunës", ka deklaruar Haziri.

Ky është granti i shtatë që Gjilani fiton brenda katër vjetësh në kuadër të SMPK-së, kurse totali i shpërblimit shkon rreth 2 milionë euro. Nga grantet e kaluara, përveç tjerash, është ndërtuar pjesa e parë e Rrugës së Kumanovës, rrethrotullimi te hyrja në rrugën e Prishtinës, asfaltimi i rrugëve me elementet përcjellëse në lagjen Porodin etj.



Filloi ndërtimi i çerdhes së dytë publike në Malishevë



MALISHEVË, 9 SHTATOR (ER) - Të mërkurën në Malishevë edhe zyrtarisht ka filluar ndërtimi i objektit të çerdhes së dytë publike, e cila është një nevojë e kohës. Në fillimin e punimeve në ndërtimin e kësaj çerdhe ishin të pranishëm i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori për

Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ai i urbanizimit, Ahmet Morina, drejtoresha e çerdhes aktuale, Behare Shala dhe zyrtarë të tjerë përgjegjës. "Tani po ndërtojmë edhe çerdhen e dytë në qytetin e Malishevës dhe me këtë besojmë se deri-diku i plotësojmë nevojat për të gjitha ato

nëna të cilat punojnë. Së shpejti do ta fillojmë ndërtimin e çerdhes së tretë në Kijevë dhe besoj se kjo do t'u ndihmojë familjeve të cilat do t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe", ka thënë Begaj, i cili ka treguar se "është i bindur se çdo ditë e më tepër po krijojnë kushte më të mira për të gjithë".

Pronari i kompanisë "Lindi doors" dhuron katër bursa për studentët e Skenderajt

SKENDERAJ, 9 SHTATOR (ER) - Pronari i kompanisë "Lindi doors", Enver Mulaj, ka dhuruar katër bursa për studentët e Komunës së Skenderajt në vlerë prej 300 eurosh për secilin prej tyre. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, në

emër të studentëve ka falënderuar donatorin Mulaj për përkrahjen dhënë studentëve të Komunës së Skenderajt. "Mirëpresim dhe vlerësojmë lart kontributin dhe humanitetin e secilit donator", ka thënë Jashari.



Nis rregullimi i shtratit të përroit në Optrushë të Rahovecit

RAHOVEC, 9 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, bashkë me zëvendësministren e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Magbule Shkodra dhe bashkëpunëtorë dhe qytetarë, mori pjesë në fillimin e punimeve të projektit për rregullimin e shtratit të përroit në Optrushë.

Kryetari Latifi ka thënë se projekti në fjalë është bashkëfinansim ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe MPL-së dhe kushton 142 mijë euro. Ai ka thënë se Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas kësaj kontrate, do të realizojë, përveç

në Optrushë, edhe projektet e trajtimit të përrënjeve në Pataqan të Ulët, Malësi të Vogël dhe Polluzhë. "Shtrati i përroit në Optrushë, i gjatë 762 metra, do të ketë ndriçim publik, urë në rrugën kryesore 8.2 metra gjerësi si dhe trotuar në të dyja anët. Në projekt është përfshirë edhe kanalizimi fekal me gypa plastikë të brinjëzuar për 262 metra gjatësi, si dhe do të ketë ura të vogla (lëshesa) kaluese për shtëpitë përkaj përroit. Një projekt i tillë do t'i parandalojë papastërtitë, vërshimet dhe do të ndikojë në përmirësimin e kushteve mjedisore, duke i dhënë pamjen e merituar kësaj zone", ka thënë Latifi.



Për 24 orë, gjashtë viktima dhe 76 raste të reja me Covid në Kosovë

Në Kosovë u konfirmuan të mërkurën edhe gjashtë viktima nga Covid-19 dhe 76 raste të reja pozitive. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka njoftuar se rastet e reja rezultojnë nga testimi i 589 mostrave. Sipas raportit të Institutit, në 24 orët e fundit janë shëruar edhe 144 pacientë. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i të infektuarve në Kosovë arrin në 14 377, i viktimave në 574 dhe i të shëruarve në 10 926

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 589 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 76 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar edhe gjashtë raste të vdekjes me Covid.

Numri total i rasteve pozitive është 14 377 raste nga 55 513 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 574 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 144 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 926 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 877.

Rastet pozitive brenda 24 orëve të fundit janë nga: komuna Prishtinë 14 raste, komuna Gjilan 7 raste, komuna Podujevë 7 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Malishevë 5 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna

Mitrovicë 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Lipjan, Rahovec dhe Shtime.

Aktualisht, në Qendrën Klinike

Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale janë të shtrirë 347 pacientë, prej këtyre 263 janë të infektuar me koronavirus. Sipas raportit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik

Universitar të Kosovës, katër pacientë janë në respiratorë, 22 në makinat e frymëmarrjes CPAP, ndërsa 231 të tjerë janë duke u trajtuar me oksigjenoterapi.



Veseli takon strukturat e partisë në Obiliq

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga deputeti Bajrush Xhemajli, ka takuar strukturat e partisë në Obiliq. Në këtë takim Veseli ka folur për situatën politike nëpër të cilën po kalon Kosova si dhe sfidat me pandeminë. Veseli ka shprehur mbështetjen e tij dhe

të partisë për degën e Obiliqit dhe ka inkurajuar ata që ta vazhdojnë punën në të mirë të qytetarëve të kësaj komune. Kryetari i Degës së PDK-së në Obiliq, Lulzim Sadiku, ka falënderuar kryetarin Veseli për mbështetjen dhe është zotuar se puna në interes të qytetarëve do të jetë fokusi kryesor edhe më tej.

Qendra Universitare Frankofone pranon donacion 2 500 libra

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Pak para fillimit të vitit të ri akademik 2020/21, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka pranuar një donacion librash nga ish-deputeti i kantonit të Gjenevës, Eric Leyvraz dhe kryetari i shoqatës shqiptaro-frënge, Tahir Shabani. Ky donacion i është dhuruar Qendrës Universitare Frankofone të UP-së dhe përmban libra në gjuhën frënge nga lëmenj të

ndryshëm, siç janë: muzika, arkeologjia, gjuhësia, letërsia dhe tekste për kulturë të përgjithshme. Donacioni numëron rreth 2 500 tekste nga fushat e përmendura më sipër. Përveç të tjerash, deputeti Leyvraz dhe kryetari Shabani kanë siguruar edhe transportin për këta libra nga Gjeneva për në Prishtinë.

Qendra Universitare Frankofone është një hapësirë e pajisur me burime edukative

dhe pajisje të avancuara teknike, për modernizimin e mësimdhënies, rritjen e atraktivitetit të ofertave universitare frankofone dhe rritjen e dukshmërisë së veprimeve lokale frankofone përmes aktiviteteve specifike të organizuara.

Universiteti i Prishtinës e përshëndet këtë iniciativë si dhe shpreson gjithmonë në bashkëpunime të tjera në të mirën e studentëve të UP-së.



Gastronomët kërkojnë zgjatjen e orarit të punës

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës edhe një herë i ka kërkuar kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hotit dhe ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, që ta shfuqizojnë vendimin për kufizimin e lëvizjes. Shoqata e Gastronomëve ka bërë thirrje që të zgjatet orari i punës për sektorin e gastronomisë deri në orën 00:00. "Ne si shoqatë, me anë të kërkesave të anëtarëve tanë, bëjmë thirrje që vendimi aktual i Qeverisë së Republikës së Kosovës të shfuqizohet dhe, përveç kësaj, natyrshëm kërkojmë edhe zgjatjen e orarit të punës për sektorin e

gastronomisë deri në orën 00:00", thuhet në kërkesën e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës.

Sipas kësaj shoqate, gjendja aktuale sa i përket këtij sektori është shqetësuese. "Si rrjedhojë e masave të ushtruara nga ana e institucioneve të Kosovës, shumë biznese rrezikojnë të mbyllën nga pengesat që janë shkaktuar në afarizmin e tyre. Deri më tani nuk kemi pasur asnjë mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj bizneseve nga institucionet tona, por vetëm ndaj punëtorëve me anë të Pakos Emergjente, dhe kjo me shumë lëshime në zbatim", theksohet në njoftimin e kësaj shoqate.



Tetëmbëdhjetë kandidatë në garë për drejtor të Doganës

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Në konkursin për drejtor të përgjithshëm të Doganës së Kosovës kanë aplikuar tetëmbëdhjetë kandidatë, ndër ta edhe ish-drejtori i këtij institucioni, Bahri Berisha dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit, Ibrahim Xhaka.

Në listën prej tetëmbëdhjetë kandidatëve janë në garë: Betim Elezaj, Ardian Jashari, Bahri Berisha, Arlind Limani, Fetah Zejnullahu, Agim Nika, Ibrahim Xhaka, Bekim Mehmetaj, Bashkim Arifi, Agron Sadiku, Nehat Daki, Besim Curri, Gyltene Sylja



Kastrioti, Feim Brava, Ekrem Hajdari, Fatmir Miftari, Shkëlzen Mustafa dhe Agron Llugaliu.

Ministria e Financave ka shpallur konkursin për drejtor të përgjithshëm të Doganës së Kosovës më 3 gusht dhe është mbyllur më 1 shtator.

Ishte thënë se ky proces i rekrutimit do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Rekrutime në Pozita të Larta Drejtuese. Edhe ish-ministri i Financave, Besnik Bislimi, kishte hapur konkurs në muajin shkurt për këtë pozitë, por ishte pezulluar.

Indeksi i kostos së ndërtimit shënoi rënie në Kosovë



PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2020. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pësoi rënie për (-0.1 për qind) në tremujorin e dytë (TM2 2020), krahasuar me TM1 2020. "Rënie më të madhe kishin transportet (- 4.0 për qind); energjia (-1.8 për qind); dhe kostot e tjera (-0.8 për qind). Rënia e çmimeve u neutralizua kryesisht me ngritjen e çmimeve të makineritë (0.5 për

qind) dhe të materialet (0.2 për qind)", thuhet në njoftimin e ATK-së. Sipas ATK-së, krahasuar TM2 2020 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM2 2019), Indeksi i Kostos së Ndërtimit pësoi rënie për (-1.3 për qind). "Rënia e indeksit kryesisht u vërejt te kategoritë: pagat (-3.3 për qind); materialet (-1.6 për qind); dhe energjia (-1.0 për qind)", thuhet në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, ngritje pati te: transporti (8.0 për qind); makineritë (1.7 për qind); dhe kostot e tjera (0.2 për qind).

Reçica dhe Jashari merren vesh për bashkëpunim në të mirë të qytetarëve

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të mërkurën ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, me të cilin ka diskutuar për gjendjen e krijuar në vend si pasojë e pandemisë, me theks të veçantë në qytetin e Skenderajt. Ministri i MPMS-së, Skender

Reçica, bashkë me të parin e Komunës së Skenderajt, janë marrë vesh që sa më parë t'i fillojnë bashkëpunimet konkrete në funksion të mbështetjes dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve në këtë komunë. "Me kënaqësi prita sot në takim kryetarin e Komunës së Skenderajt, mikun tim z. Bekim Jashari, me të cilin diskutuam për

gjendjen e krijuar në vend si pasojë e pandemisë, me theks të veçantë në Komunën e Skenderajt. Bashkë me kryetarin Jashari u pajtuam që sa më parë t'i fillojmë bashkëpunimet konkrete në funksion të mbështetjes dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë në Skenderajt", ka shkruar Reçica në profilin e vet në "Facebook".



Qeverisja e mirë korporative kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Implementimi i parimeve të qeverisjes korporative të Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke rritur performancën e këtyre kompanive dhe duke ua lehtësuar atyre mundësitë për qasje në kapital të jashtëm. Kjo u tha në një punëtori virtuale të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbi qeverisjen korporative të NVM-të, përkrahur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe

Zhvillim (BERZh). Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se Oda Amerikane i kushton rëndësi qeverisjes së mirëfilltë korporative pasi që e njëjta ka ndikim pozitiv në përmirësimin e prospekteve për qasje në financa, luftimin e korrupsionit, si dhe menaxhimin e ndërmarrjeve në përgjithësi. Ndërsa Vlora Avdiu-Burani, përfaqësuese e programit të BERZh-it Këshilla për Biznese të Vogla, ka theksuar se ky program mbetet i hapur ndaj ofrimit të mbështetjes për NVM-të vendore lidhur me qeverisjen korporative, ndërsa

u bëri thirrje atyre që t'i adresojnë sfidat të cilat ata i hasin përmes këtij programi. Kjo punëtori u udhëhoq nga Visar Dobrosi, partner menaxhues në kompaninë Recura Financials. Dobrosi ka potencuar shtyllat kryesore mbi të cilat duhet të bazohet qeverisja korporative, të cilat janë mbajtja e përgjegjësisë, llogaridhënia, korrektësia dhe transparencja. Ai ka përmendur edhe përfitimet e kompanive nga strategjia e mirë e qeverisjes korporative, e cila siguron vazhdimësinë dhe fuqizimin e mëtejshëm të ndërmarrjeve, tërheqjen e investitorëve, mbajtjen e stafit si dhe rritjen e performancave. Sipas tij, në

mënyrë që udhëheqësit e bizneseve të sigurojnë menaxhim sa më të mirë të veprimtarive të tyre, duhet të krijojnë një mjedis të mirë dhe fleksibil pune, si dhe ta sigurojnë përfshirjen e stafit në përpilimin e politikave të kompanive. Më tutje, ai ka përmendur disa nga sfidat me të cilat përballen ndërmarrësit sot, siç janë: tërheqja dhe mbajtja e stafit të duhur në kompani, përshtatja ndaj ndryshimit të pritshmërive të gjeneratave të reja. Dobrosi theks të veçantë u ka kushtuar edhe llojeve të ndryshme të vendimmarrjes si vegël kyçe për planifikimin e vazhdimësisë, ku ka veçuar vendimmarrjen e përbashkët, e

cila krijon sinergji dhe kombinon talentin dhe përvojën e të gjithë individëve që përbëjnë kompaninë. Ai zbërtheu hapat kryesorë për diagnostifikimin e planifikimit të veprimit korporativ, derisa theksoi se kompanitë me plan të mirë të menaxhimit rezultojnë më të afta për përballimin e sfidave të ndryshme. Përfaqësuesit e bizneseve anëtare të Odës Ekonomike Amerikane të cilët ishin pjesë aktive e kësaj punëtorie patën mundësi të diskutonin mbi qeverisjen korporative si dhe t'i ofronin perspektivat e tyre mbi strategjitë e kompanive të cilat përfaqësojnë.

Pesë mijë hektarë tokë bujqësore futen nën sistem të ujitjes

GIKOVË, 9 SHTATOR (ER) - Në Doblbarë të Komunës së Gjakovës është përfunduar faza e parë e punimeve rehabilituese në sistemin e ujitjes Radoniq - Dukagjini. Ky investim do ta rrisë produktivitetin dhe sigurinë ushqimore në këtë rajon. Në ceremoninë e inaugurimit të këtij projekti, të pranishëm ishin: kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, min-

istri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, kryetari i komunës, Ardian Gjini, drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Durim Halilaj, bujq dhe banorë të zonës së Dukagjinit. Kryeministri Hoti u shpreh se nuk ka investime më produktive sesa ato në sistemin e ujitjes. Ndërkaq kryetari Gjini

ka përgëzuar të gjithë bujqit e zonës së Dukagjinit për këtë projekt, frytet e të cilit do të shihen shumë shpejt. Projekti për rehabilitimin e sistemit të ujitjes Radoniq - Dukagjini përkrahët nga Banka Botërore. Përmes një videomesazhi, është paraqitur edhe menaxheri i Zyrës së Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoninë Veriore, Massimiliano Paolucci.





Të gjithë për Grenellin, të gjithë kundër Grenellit!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Bisedime jotransparente dhe marrëveshje të dyshimta: Mungesa e transparencës ka qenë "thembra e Akilit" gjatë tërë procesit të negociatave, prandaj ka lënë hapësirë për interpretime të ndryshme e që janë keqpërdorur kryesisht për qëllime politike. Është e ditur që në bisedime të ndjeshme e që janë të ndërmjetësuara nuk dalin informata për atë çka negociohet me përjashtim të rasteve që disa informata lëshohen si balona provues për t'u testuar reagimi i opinionit. Edhe gjatë bisedimeve midis Izraelit dhe Palestinës asnjëherë nuk kanë janë bërë publike ato që janë biseduar deri kur është arritur marrëveshja përfundimtare. Në këtë kontekst, as Kosova nuk bën përjashtim andaj janë pritje të tepruara të opinionit që të informohen për çdo gjë që bisedohet, në të kundërtën bisedimet as që do të kishin kuptim. Mirëpo, në anën tjetër është moralisht e papranueshme që politikanët e Kosovës të gënjejnë aq shumë,

ndërmjetësuesit ndërkombëtarë edhe më shumë në kohën kur transparencën e kanë në majë të gjuhës dhe në të gjitha raportet për Kosovën, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies janë pika të zeza që po e penguan zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Marrëveshja e Uashingtonit për ta ashtuquajturin normalizim ekonomik midis Beogradit dhe Serbisë, në tërë përpjekjen për ta fshehur qëllimin final, megjithatë kishte pjesë të lakuriqësuar. Pjesët e lakuriqësuar po përdoren si karrem për opinionin. Marrëveshja e Uashingtonit është pjesë e fushatës zgjedhore të presidentit Trump apo keqpërdorim për qëllim të fushatës prandaj edhe fituesi absolut ishte Trumpi, pastaj Serbia dhe në fund, çka të mbetet edhe për Kosovën. Nëse realizohet premtimi se ShBA do të investojnë 13 miliardë dollarë në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Serbisë atëherë padiskutueshëm edhe Kosova do të përfitojë. Disi, shumica është aq e madhe për të besuar dhe unë i kam rezervat se kjo do të përmbushet dhe se edhe kjo po keqpërdoret për qëllime elektorale. Delegacioni i Kosovës është futur në gërshtë të seksit politik apo prostitucionit politik midis ShBA-së dhe BE-së dhe po përdoret si top pingpongu. Ose,

më mirë të them si thes ku e ushtrojnë forcën dhe dhunën kundër vullnetit të qytetarëve të Kosovës dhe realitetit në Kosovë. Pas Marrëveshjes së Uashingtonit, ekipi negociator (kurrë nuk kemi pasur ekip më të dobët dhe më jokompetent) zbarkoi në Bruksel për takim me kundërshtarët e përbetuar dhe të papërmirësueshëm të pavarësisë së Kosovës; Borelli, Lajçaku, çetniku dhe kriminelin i luftës Aleksandar Vuçiq dhe ngjizja e neoçetnikizmit, Marko Gjuriq. Edhe këtu, kryeministri i Kosovës Avdullah Hoti e ripërsëriti frazën se me palën serbe do të bisedohet vetëm për njohje reciproke por se tash e tha se ky është synim i cili do të realizohet brenda një viti që nuk është asgjë tjetër veç stërzgjatje e rrenës dhe mashtrimit apo plasimi i rrenës në formë të serialit në kohën që premtimin për njohje reciproke që e kishte të vetmin qëllim në bisedimet në Uashington në mënyrë arrogante ia shkërdheu Grenell, së bashku me kriminelin e luftës, Aleksandar Vuçiq duke e hequr si pikë e veçantë e marrëveshjes. Po në të njëjtën mënyrë ua shkërdhën refuzimin për mini Shengenin ballkanik si dhe Ujmanin. Kam menduar se delegacioni i Kosovës, me gjithë mungesën e kompetencës dhe kredibilitetit, do të duhej ta mbronin interesin e shtetit të Kosovës e jo të

përmbushnin kërkesat e presidentit Trump, emisarit arrogant dhe agresiv Grenell dhe të tjerëve. Si të shpjegohet ndryshe prostituimi negociator kur thuhet se këtë apo atë e kemi bërë për arsye se na është lutur presidenti Trump apo për hir të Amerikës ndonëse nuk ka qenë në rregull! Favoret personale nuk mund të bëhen duke e dëmtuar shtetin dhe mandatin që e keni. Ju mund t'i lëshoni brekët edhe para Trumpit sikur edhe para Grenellit, si favor dhe kontribut personal por këtë nuk mund ta bëni në emër të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Në një vend normal të tillët do ta kishin problem të kthehen në Kosovë kurse, në Kosovë, me një ndryshk dhe korrupsion moral dhe material, mbi këto baza sigurohet mbijetesa politike dhe ndërtohet karrierë. Pas takimit në Bruksel, BE-ja deklaroi se nuk mund të japin asnjë informatë për faktin se jemi në një periudhë të ndjeshme duke ngritur dilemat për rezultatet përfundimtare në ndërkohë që delegacioni nga Kosova nuk guxon ta nxjerrë një fjalë të vetme përveç përveç së rrenës se: "nuk bisedojmë për asgjë tjetër përveç njohjes reciproke ..." të cilën tash nuk e kanë më si kusht por si një synim....

Hanibal Grenell ante portas: Në Kosovë e kemi një situatë jonormale kur karrierën politike,

marrjen e pushtetit dhe ruajtjen e këtij pushteti e projektioni duke u mbështetur te koçet e të tjerëve. Sidomos kjo ka qenë e theksuar kohëve të fundit kur shumë politikanë u eliminuan apo po bëhet përpjekje për pushkatim politik duke u akuzuar për anti-amerikanizëm e që po identifikohet se nuk po pajtoheni të mendoni apo të përkrahni 100 për qind atë që e thonë presidenti Trump dhe emisari Grenell në kohën kur më shumë se 50 për qind e amerikanëve nuk i besojnë Trumpit dhe për Grenellin e marrin vesh se qenka gjallë vetëm për shkak të sjelljeve konfrontuese sa ishte ambasador në Gjermani dhe se kur pushkaton të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër e kundërshtojnë, qoftë edhe si kundërshtim kolateral ndonëse nuk fërkohen fare me Hanibal Grenellin. Në mbrojtje të Dullës e sulmoi ashpër, pa asnjë arsye Vjosa Osmanin, kryetare e Kuvendit ndërsa Albin Kurtin dhe LV-në e ka pjesë së menysë së përditshme. Krijohet një përshlyetje që Hanibal Grenell dhe Albin Kurti kanë krijuar një raport ndërvartësie dhe se nuk mundën pa njëri-tjetrin. Kemi një situatë të ulët dhe të mjerë kur disa politikanë dhe parti politike në Kosovë, tërë aktivitetin politik, në mungesë të një kontributi më kreativ, e



ndërtojnë duke e cilësuar Albin Kurtin si antiamerikan dhe shkatërrues të raporteve Amerikë - Kosovë. Me shprehje seksuale, për shkak të impotencës së veprimit politik, Albin Kurti e përdorin si viagrën apo stimulues që do t'i mbante

gjallë! E pamoralshme dhe e pandershme, skajshmërisht. Me këtë po i vendosin Hanibal Grenellit topin në 11-ësh, duke e lënë portën pa asnjë mbrojtje! Këtë Hanibal Grenell po e keqpërdorë pamëshirshëm kurse edhe Albin Kurti po ia bënë ndihmësin me deklarata dhe veprime që, edhe Albini e ka të qartë se janë të perealizueshme. Ju kujtohet se Albini pati deklaruar se me të ardhur në pushtet LV-ja, ata do ta zhbëjnë Gjykatën Speciale dhe asnjë të dyshuar apo të akuzuar nuk do t'ia dorëzojnë kësaj gjykate duke e pasur të qartë se pikërisht ShBA-të janë kumbar për themelimin e kësaj gjykate. E morën pushtetin dhe deklaruan se të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare i kanë gjetur të nënshkruara dhe të ratifikuara andaj nuk mund të bëjnë asgjë sepse janë para aktit të kryer. Edhe tash, ndonëse nuk ka asnjë nevojë të fitojë vota në zgjedhje të parakohshme e të cilat nuk do të mbahen sepse, nëse edhe hipotetiki do të mbahen LV-ja do të jetë fituese, politikisht është vetëvrasje nëse deklaroni se: "posa të marrim pushtetin do ta anulojmë marrëveshjen e Uashingtonit..." Edhe nëse e marrin pushtetin, do të veprojnë njëjtë si me rastin e Gjykatës Speciale duke thënë se ne nuk e kemi përkrahur por se të tjerët e

kanë nënshkruar. Me këtë Albin Kurti po ua mbushë pushkën injorantëve politikë në Kosovës sikur edhe Hanibal Grenellit në Uashington! Papjekuri dhe adoleshencë politike! Tash, ua bëjë një pyetje të gjithë atyre që e ushqejnë Hanibal Grenellin me "antiamerikanizmin" e Albin Kurtit se për çfarë arsye duhet ta pranojmë çdo gjë që e thotë Hanibal Grenelli. Është e mjerë ajo politikë apo politikan që donë të bëjë karrierë politike duke e pohuar amerikanizmin e vet dhe duke e denoncuar antiamerikanizmin e tjetrit sikur edhe ai që do të bëjë karrierë politike duke kundërshtuar çdo gjë që vjen nga Hanibal Grenelli dhe shpura e tij. Latinët thoshin se në mes është e vërteta, in media res, prandaj çdo ekstrem është i dëmshëm. Në fund të fundit, të gjithë e duan mesin sepse boshti i botës nuk është në skaje por në mes. Si dhe shumë gjëra të tjera, të këndshme për njeriun dhe njerëzimin. Më habit fakti se disa portale e denoncojnë vëllanë e Fitore Pacollit se paska ftuar që në 'Twitter' të kundërshtohet Hanibal Grenell. Hanibal Grenelli paska të drejtë të bëjë ç'të dojë, kurse të tjerët nuk paskan të drejtë ta kundërshtojnë atë. Përrulje dhe servilizëm, deri në neveri!

Zhvillimet e fundit që prodhojnë efekt si një pordhë e ftohtë: LV-ja

kërkon mocion për rrëzim të qeverisë Hoti ndonëse nuk, as numra e as përkrahje. Bën gabime elementare të një adoleshenti politik; në një rën anë vendosë vija të kuqe ndaj partisë që ka shumë deputetë, në anën tjetër kërkon përkrahje nga kjo parti. E quan kryeministrin Hoti ilegjitim në kohën kur ky është zgjedhur kryeministër me 61 vota të deputetëve të Kuvendit dhe se askush që e di edhe shkronjën A të politikës nuk mund të thotë se kryeministri Hoti është ilegjitim apo ilegal. Kryeministri Hoti është krejtësisht legjitim dhe kjo nuk mund të kundërshtohet. Tjetër çështje është nëse e kontestoni punën që bënë.

PDK-ja po paraqitet si opozitë e biseksualitetit parlamentar ku zëdhënësi paraqitet më me peshë se vet kryetari. E quan qeverinë Hoti mashtruese, ka vërejtje për marrëveshjen përkatësisht për mini Shengenin dhe Ujmanin, preferon zgjedhje të parakohshme kurse deklaroi se do ta konsiderojnë mocionin e LV-së vetëm kur ata e sjellin në Kuvend listën me 61 nënshkrime! Nëse LV-ja i siguron 61 nënshkrime, çka i duhet atëherë përkrahja e PDK-së?! PDK-ja ose duhet të sillt vërtetë si opozitë, ose duhet të bëhet pjesë e qeverisë!

AAK-ja po kërcënon me dalje nga qeveria Hoti, sa herë që nuk po punojnë semaforët. Janë bërë

joseriozë; thërrasin mexhllisin e partisë për të diskutuar për dalje nga qeveria e pastaj thonë se kanë diskutuar nëse Mesi do të luajë për Barcelonën! Po e luajnë lojën e inxheve sepse, kjo AAK-ja, në këtë situatë kurrë nuk do të dalë nga qeveria! Të jeni të sigurt për këtë!

Shumë po flitet për zgjedhje të parakohshme e këto nuk do të mbahen. Askush nuk i do zgjedhjet përveç LV-së që do të dali fituese. Përralla janë këto kërkesa dhe kërcënime. Edhe për presidentin do ta gjejnë një zgjidhje, pa shkuar fare në zgjedhje!

Në Kosovë shpërtheu një pordhë e kombinuar, hidrogjenike dhe atomike por që nuk e pati efektin, as të parës e as të dytës. Nuk pësuau njerëzit e as objektet përveçse iu dha mundësia çdo injoranti që, nga pozita e ekspertëve të japin vlerësime si ndodhi, pse ndodhi dhe se çka do të ndodhë në të ardhmën. A janë materiale që i ka shitur dikush nga Serbia, dikush nga vet Gjykata Speciale apo ndonjë haker që ka hyrë në sistemin e kësaj gjykate. Mirëpo është fakt se në këtë rast më së shumti do ta pësojnë dëshmitarët e mbrojtur që asnjëherë nuk kanë qenë të mbrojtur pasi janë "vrrarë" pikërisht nga ata që është dashur t'i mbrojnë; nga Tribunali i Hagës, nga UNMIK-u, nga EULESH-i dhe, së fundi, do të vriten nga Gjykata Speciale!

Dumoshi: Synimi im, finalizimi i objektit të Teatrit të Operës dhe Baletit

PRISHTINË, 9 SHTATOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në takim Këshillin e ri Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës, i cili është në përbërje të Leonora Rexhepi, Luljeta Ademi, Lejla Pula, Agim Selimi dhe Zethane Bahtiri-Gimolli, përfaqësuese e MKRS-së. Ministrja Dumoshi e informoi këshillin për punën dhe planet që MKRS-ja po bën për kulturën, në këtë kontekst edhe për avancimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike për Baletin Kombëtar të Kosovës.

Një ndër sfidat e cila ka pasur vonesa dhe nuk ka arritur të konkretizohet ende është objekti i Teatrit të Operës dhe Baletit, për të cilin ministrja tha se është e interesuar që të finalizohet si proces dhe ky projekt të marrë jetë. "Kemi shumë artistë të talentuar dhe është mëkat që mos të kenë hapësirën e duhur dhe të nevojshme ku t'i realizojnë aktivitetet e tyre. Si ministre dhe ministria që drejtoj jemi të interesuar që sa më shpejt të jetësohet projekti i objektit të Teatrit të Operës dhe Baletit. Kemi mbajtur komunikim të



vazhdueshëm me Komunën e Prishtinës, ashtu që hapësira që është paraparë për ndërtimin e këtij objekti të rëndësishëm të kulturës në Kosovës, afër Fakultetit Teknik në Prishtinë, të ndahet për projektin në fjalë", ka pohuar ministrja Dumoshi, duke i bërë thirrje edhe komunitetit artistik që ta japin kontributin e tyre dhe të ngrenë zërin për këtë çështje. "Projektet garuese për objektin e teatrit do të bëhen transparente dhe qytetarët do ta kenë mundësinë që ta japin

kontributin e tyre për përzgjedhjen e projektit më të mirë", ka thënë ajo.

Po ashtu, ministrja Dumoshi ka theksuar se do të bashkëpunojë me Këshillin, por asnjëherë pa ndërhyrë në punën dhe vendimet që ata marrin si këshill. Dumoshi ka thënë se duhet që sa më shpejt të zgjedhet drejtori i Baletit Kombëtar të Kosovës me qëllim të funksionalizimit të plotë të këtij institucioni të rëndësishëm të kulturës së vendit tonë. Një ndër temat që është edhe

një preokupim, është edukimi i gjeneratave të reja në fushën e baletit. Për këtë ministrja Dumoshi ka thënë se do të punojmë bashkërisht që ta zgjidhim çështjen e shkollës së baletit dhe ajo si ministre do të llobojë dhe do të komunikojë edhe me Ministrinë e Arsimit për të zgjidhur këtë problematikë sepse, siç tha ministrja, "nuk na falet si shoqëri nëse e lëmë që baleti të shuhet në vendin tonë e mos të ketë breza të rinj të edukuar në këtë fushë".

Anëtarët e Këshillit të Baletit e falënderuan ministrin Dumoshi për pritjen dhe besimin e treguar. Ata thanë se do të punojnë dhe të angazhohen për ta avancuar baletin, duke u fokusuar edhe në edukimin e brezave të baletit në Kosovë, duke vazhduar traditën e profesorit të Ahmet Brahimajt.

Ndër të tjera, ministrja Dumoshi e njoftoi këshillin edhe për përkrahjen që ka dhënë MKRS-ja për organizatat e shoqërisë civile që merren me kulturë.



Vlora para Vlorës: Ngjarjet që përgatitën epopenë e vitit 1920

Nga: Pëllumb XHUPI

Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore ishte po aq e rëndë sa ç'kishte qenë në 1913-ën në Londër, pas luftërave ballkanike. Madje, edhe më e rëndë. Austro-Hungaria, përkrahëse e shtetit të pavarur shqiptar, ishte humbëse e luftës dhe nuk i mbijetoi asaj. Italia, që gjithashtu pati rolin e saj në njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, pas luftës u kthye në një makth për shqiptarët, pasi këmbëngulte në zbatimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës 1915, me të cilin vendet e Antantës i kishin premtuar Italisë aneksimin e Vlorës e të hinterlandit të saj, si dhe mandatin mbi pjesën tjetër të territorit shqiptar.

Pretendimi italian inkurajonte edhe aspiratën e Greqisë e të mbretërisë Serbo-Kroate-Sllavone (Jugosllavisë) për të aneksuar Jugun dhe Veriun e Shqipërisë. Në fakt, Beogradi e bëri të qartë se në rast të shkëputjes së territoreve shqiptare nga vende të tjera (nënkuptohej Italia e Greqia), ai

do kërkonte aneksimin e krejt bllokut në veri të lumit Drin, bashkë me Shkodrën, si dhe bregun e djathtë të Drinit të Zi. Nga ana e saj, Greqia e konsideroi fundin e kësaj lufte si rastin e përshtatshëm për të realizuar aneksimin e Shqipërisë së Jugut, bashkë me territore të tjera në Dodekanez, Thrakë e Azi të Vogël.

Greqia u bind të rreshtohet në krah të Antantës vetëm në muajt e fundit të luftës, ku luajti një rol të papërfillshëm në fitoren e armëve aleate. Në fakt, humbjet e saj llogariteshin në vetëm 4917 veta, mes të vrarëve, të plagosurve dhe të humburve, në një kohë që shifra e të vrarëve të palëve ndërluftuese ishte në disa milionë ushtarë. Pavarësisht nga kjo, Greqia pati në ditët e muajt e Konferencës së Paqes mbështetjen tradicionale të Francës, por edhe atë të interesuar të Britanisë së Madhe. Në bisedimet paraprake që pati me kryeministrin Lloyd George, Venizelosi e pati të lehtë ta joshë atë, duke premtuar se do vinte në dispozicion të flotës britanike të gjitha portet e bazat detare greke. Kështu, në janar 1919,

Shqipëria paraqitej në Konferencën e Paqes së Parisit e vetmuar siç nuk kishte qenë as në Kongresin e Berlinit (1878), e as në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës (1913), ku gjithashtu ishin vendosur fatet e saj.

E vetmja dritë shprese që vinte nga Të Mëdhenjtë, ishte plani 14 pikash mbi paqen në Evropë, i paraqitur në 8 janar përpara Kongresit, i cili paralajmëronte një revolucion në marrëdhëniet ndërkombëtare, deri atëherë bazuara në ekuilibrin e forcave mes të mëdhenjve. Tash e tutje ato duhet të mbështeteshin në të drejtën e popujve për të vendosur për fatet e tyre. Jo rastësisht politikani e diplomati i hollë, Ismail Qemali, qe ndër të parët që e kapi që në ajër kuptimin e deklaratës së Wilsonit. Duke e quajtur atë "apostull të paqes dhe të lirisë së popujve", Ismail Qemali shkruante në plot entuziazëm se "duke filluar nga sot, merr jetë perandoria e së drejtës dhe fillon epoka e drejtësisë universale". Por, po të kishte jetuar pak më gjatë, Plaku i Vlorës do kishte parë se me gjithë futjen e

fuqishme të faktorit amerikan në politikën evropiane, rolin drejtues në Konferencën e Paqes së Parisit e morën anglezi Lloyd George dhe francezi Clemenceau dhe këta ishin të vendosur të mbështesnin pretendimet e klientëve të tyre ballkanikë.

Sa u përket atyre greke mbi Shqipërinë e Jugut, Jules Cambon, kryetar i Komisionit për çështjet greko-shqiptare, e shprehu qartë pozicionin e Francës kur qysh në mbledhjen e parë të atij Komisioni deklaroi se "Konferenca e Paqes ofronte mjetin më të mirë për të kënaqur rivendikimet e hershme të kombit grek, duke plotësuar më në fund veprën e pavarësisë të filluar një shekull më parë nga Kombet Liberale të Evropës". Nga ana e tij, përfaqësuesi anglez, Sir Eyre Crowe, i mbështeti pa rezervë pretendimet greke mbi Shqipërinë e Jugut dhe kur përfaqësuesi amerikan Day i kujtoi se ai territor banohej nga një popullsi në shumicë dërrmuese shqiptare, Crowe, plot cinizëm, tha: "Nuk prish punë, populli grek ka aftësi të

mëdha asimiluese!"

Kështu, i sigurt në mbështetjen e Francës e Britanisë së Madhe, e pavarësisht se delegacioni i qeverisë së Durrësit në Konferencën e Parisit, me Mihal Turtullin e Mehmet Konicën si dhe anëtarin italian i Komisionit, Kolonel Castoldi, i hodhën poshtë argumentet e statistikave e sajuara greke, Venizelos ishte i sigurt në triumfin e kauzës së tij. Ndërsa debatet mbi çështjen e kufirit shqiptaro-grek vazhdonin, ai drejtonte në mënyrë të ethshme nga Parisi përgatitjet për marrjen në dorëzim të "Vorio-Epirit". Kështu, qysh në 3 shkurt, ai porosiste ministrin e Luftës në Athinë të përfundonte mobilizimin e rekrutëve të vitit 1919, për t'i dërguar në vendet që Konferenca e Paqes do i akordonte Greqisë. Me urdhër të tij, kryepeshkopi grek i Durrësit, Jakovi, u transferua urgjentisht për në Korçë, ku duhet të përgatiste kushtet për hyrjen e trupave greke, pa ndeshur në qëndresën e popullsisë. Leja formale për një transferim të tillë politik të kryepeshkopit u nxor

menjëherë nga Patrikana e Stambollit.

Po me urdhër të Venizelosit, nga zonat kufitare me Shqipërinë filluan të nisen peticione, të organizohen manifestime të zhurmshme të organizuara nga "sillogjet vorio-epirote", ku u bë kujdes të futeshin edhe shtetas shqiptarë të besimit mysliman. Prania e tyre do të akreditonte tezën e mbrojtur nga Venizellos në Konferencën e Parisit, sipas së cilës jo vetëm të krishterët e Shqipërisë së Jugut, por edhe myslimanët e dëshironin një bashkim me Greqinë. Në këtë atmosferë frenetike para-lufte, në 5 mars, ministri italian në Athinë, Avezzana, njoftonte Romën se në qendrat kufitare të Janinës, Camandas e Konicës po grumbulloheshin njësi të ushtrisë greke si dhe banda parashtarake, që do të depërtonin në territorin shqiptar për të organizuar një kryengritje e për të shpallur "autonominë e Vorio-Epirit", sipas skenarit të eksperimentuar në vitin 1914.

Në sintoni me këto zhvillime, në Shqipëri, me nxitje e mbështetje nga jashtë ishte ringjallur lëvizja esadiste. Kështu, gjendja sa në Konferencën e Parisit, aq edhe në Shqipëri, po bëhej gjithnjë e më shumë kritike. Në këto kushte, në qeverinë e Durrësit e në delegacionin e saj në Paris u krijua bindja se e vetmja rrugë shpëtimi për vendin ishte pranimi i një protektorati, apo "kujdestarie" të përkohshme të një fuqie të madhe, nën të cilën do të shpëtohej të paktën tërësia tokësore e Shqipërisë londineze.

Të inkurajuar nga deklaratat e Presidentit Wilson, Mehmet Konica, Mihal Turtulli e Mithad Frashëri, mbronin idenë se kjo fuqi kujdestare duhet të ishin SHBA, që nuk kishin interesa koloniale apo imperialiste mbi Shqipërinë. Opsioni i kujdestarisë amerikane mbështetej fort edhe nga Federata "Vatra" e "Partia Kombëtare Politike" në SHBA, si dhe nga shoqata të tjera patriotike në Zvicër, Rumani, Turqi etj. Megjithatë, për protektoratin italian anonte shumica e qeverisë së Durrësit dhe e delegacionit, duke filluar nga kryeministri Turhan Pasha, njëherësh edhe kryetar i delegacionit shqiptar në Paris.

Edhe pse e pranonte epërsinë e një protektorati amerikan, zëdhënësi i këtij grupimi, Mustafa Kruja, arsyetonte se "marrëdhëniet mes shtetesh nuk ndërtohen në bazë dëshirash, por mbi bazë interesash". Dhe, fatkeqësisht, thoshte ai, SHBA nuk kanë interesa në Shqipëri e Ballkan, kurse Italia politikën ballkanike e shqiptare e kishte një nga shtyllat themelore të politikës së saj të jashtme. Sigurisht, edhe ai e pranonte se lidhja me Italinë mund të kthehej në një aleancë "kundër armiqve të përbashkët", por ajo

bartte në vetvete edhe rrezikun që Italia të merrte një qasje imperialisto-koloniale ndaj Shqipërisë. Për Turtullin e të tjerë, kjo qasje ishte diçka e sigurt nga momenti që Italia insistonte në zbatimin e Traktatit të fshehtë të Londrës, që i jepte Italisë Vlorën me rrethina si dhe protektoratin mbi Shqipërinë e Mesme, ndërkohë që ajo e veriut dhe e jugut parashiheshin t'u jepeshin Serbisë e Greqisë. Në këtë mënyrë, arsyetoni ata, "qeveria italiane jo vetëm që nuk është në gjendje të mbrojë e të bashkojë të gjithë shqiptarët në një shtet të vetëm, por përkundrazi, me synimin e saj për të shndërruar Vlorën e hinterlandin e saj në një tokë italiane, është bërë shkaktarja kryesore e shkatërrimit tonë kombëtar".

Në fakt, Konferenca e Paqes u solli zhgënjime të hidhura anëtarëve të delegacionit shqiptar, si përkrahësve të një "zgjidhjeje italiane", ashtu edhe përkrahësve të "zgjidhjes amerikane". Të parët, priten më kot që italianët t'i përgjigjeshin thirrjes së qeverisë së Durrësit e të deklaroheshin publikisht në mbrojtje të tërësisë tokësore të Shqipërisë. Jo vetëm nuk e bënë këtë, por në korrik 1919 ministri Tittoni nënshkroi një marrëveshje të fshehtë me kryeministrin grek Venizelos, me të cilën Italia i njëjtte Greqisë aneksimin e Korçës e të Gjirokastrës. Marrëveshja, të cilën grekët nuk duruan ta mbajnë të fshehtë, fshiu çdo shpresë në mbështetjen e interesave kombëtare shqiptare nga ana e Italisë dhe e rrënoi përfundimisht autoritetin e qeverisë filo-italiane të Durrësit.

Nga ana e tyre, edhe përkrahësit e një marrëdhënieje preferenciale e të një mandati amerikan mbi Shqipërinë, u tronditën rëndë kur në prill 1919 Presidenti Wilson iu bashkua propozimit anglo-francez për t'i njohur Italisë sovranitetin mbi Vlorën. Siç do ta pohonte më vonë vetë Wilson, ai u

bombardua nga një valë e tërë protestash nga përfaqësuesit e organizatave shqiptare. Deri edhe "i heshturi" Turhan Pasha, protestoi pranë Presidentit Wilson. "Çudia jonë që aq më e madhe dhe e thershme", thuhej në letrën e tij, "duke qenë se populli i vogël shqiptar e kishte mbështetur të gjithë shpresën e vet mbi parimet e larta të Shkëlqesisë Suaj, që të mos copëtohen shtetet pa u marrë parasysh të drejtat kombëtare të popujve që rrojnë në to". Megjithatë, edhe në këtë fazë të parë, që mund të quhet një fazë kolaudimi me konferencën, delegacioni amerikan pengoi që kufijtë e Shqipërisë të vendoseshin shpejt e shpejt sipas ujdivëve të arritura paraprakisht midis Venizellosit e kryeministrave Lloyd George e Clemenceau. Qysh më 12 shkurt, përfaqësuesi i SHBA, Day, deklaroi se vendi i tij nuk do pranonte kufijtë e propozuar nga Venizellosi përderisa ata nuk përputheshin me kufijtë etnikë", dhe se "nuk i duhej dhënë asgjë Greqisë, pa e studiuar më parë çështjen në thellësi". Ky qëndrim, të paktën, bëri që problemi të mbetej për muaj të tërë në stand by, deri sa rrethanat të ndryshonin në favor të çështjes shqiptare.

Ngjarja e parë e madhe që ndryshoi kursin e ngjarjeve ishte thirrja e Kongresit të Lushnjës, në 21 janar 1920 dhe krijimi i një qeverie kombëtare, e cila pa përfillur atë çka po gatuhej në Paris, vendosi t'i drejtohej popullit të vet në mbrojtje të pavarësisë e të tërësisë territoriale. Vendimi për ta zhvendosur zgjidhjen e çështjes shqiptare nga Parisi në Shqipëri, duke dëbuar trupat e huaja e duke bashkuar me qeverinë e Tiranës qytetet e krahinat e lakmuara nga fqinjët, ishte një vendim unanimit i Kongresit të Lushnjës dhe i qeverisë së dalë prej tij. Mbi atë bazë u ndërta një projekt i guximshëm kombëtar për restaurimin e pavarësisë e të tërësisë

territoriale të vendit duke përdorur, si ultima ratio, deri edhe forcën. Thirrja e qeverisë gjeti një jehonë masive në popull. Në fillimin e vitit 1920 situata ishte radikalizuar aq shumë, saqë edhe një ultrakonservator, si Syrja Bej Vlora, me një gjuhë prej socialisti të thekur, të shprehej se shpëtimi i Shqipërisë do vinte ose nga një fitore esocialistëve italianë në zgjedhjet e atij viti, që sipas tij do ta shkëpuste Italinë nga politika imperialiste ndaj Shqipërisë, ose nga një kryengritje e përgjithshme e popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë, gjë që do largonte edhe rrezikun e aneksimeve greko-jugosllave.

Ndërkohë, në një sinkroni rastësore me Kongresin e Lushnjës, po më 21 janar 1920, qëndrimi i qeverisë së SHBA shënon një kthesë të fortë. Me anë të një memorandumit të shkurtër e të prerë, ajo hidhte poshtë projektin e fundit anglo-francez, atë të janarit, që pas Italisë e Greqisë kënaqte edhe oreksin e Jugosllavisë, duke i premtuar asaj Shqipërinë e Veriut. "Ne - deklaronte Wilson, - nuk mund të japim pëlqimin tonë për një rregullim, e cili qoftë për termat e dispozitave apo për metodat e përdorura për ta imponuar atë, përbën një mohim absolut të parimeve për të cilat hyri në luftë Amerika". Lloyd George e Clemenceau e kuptuan se kësaj radhe Presidenti amerikan nuk bënte shaka dhe me anë të një letre "paqtuese" nxituan ta sigurojnë atë se asnjë vendim nuk do të merrej pa miratimin e SHBA-ve dhe se interesat e popullit shqiptar do të merreshin, gjithashtu, në konsideratë prej tyre. Wilson iu përgjigj kësaj letre më 25 shkurt.

"Presidenti - thuhej aty - merr shënim me kënaqësi se qeveritë britanike e franceze nuk do të lenë pas dore interesat e ardhshme dhe mirëqenien e popullit shqiptar. Qeveria amerikane kupton fare mirë se ndarja e Shqipërisë në tri pjesë, ashtu siç parashikohet nga

marrëveshja anglo-franceze, mund të pranohej me gjithë qejf nga qeveria jugosllave, por ajo është vendosmërisht kundër që populli shqiptar të lëndohet për t'i bërë mirë Jugosllavisë, ashtu siç është kundër që populli jugosllav të lëndohet për t'i bërë favor Italisë". "Çështjet shqiptare - nënvizonte Presidenti Wilson - në një notë të fundit të 6 marsit 1920 - nuk duhet të futen në diskutimin që propozohet midis Italisë e Jugosllavisë dhe Presidenti detyrohet të deklarojë edhe njëherë se nuk do të miratonte asnjë plan që do t'i jepte Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë, në vend të diçkaje që mund t'i shkëputet gjetiu".

Kjo ndërhyrje e vendosur dhe mjaft e ashpër e Presidentit Wilson i dha fund serisë së ujdivëve të pista që gatuhehin në kuluaret e Konferencës së Paqes mbi kurrizin e Shqipërisë. Tashmë fati i Shqipërisë nuk luhej më në Paris, por në Shqipëri. Këtu atmosfera patriotike ishte ndezur, dhe falë një koordinimi e bashkëpunimi të ngushtë mes qeverisë së Sulejman Delvinës, forcave vullnetare, çetave patriotike, popullsisë dhe organeve bashkiake të qyteteve, Gjirokastra, Durrësi, Delvina, Saranda, Leskoviku, Fieri dhe Shkodra me gjithë krahinë, shpallën bashkimin me qeverinë e Tiranës, e cila vendosi aty ushtrinë dhe administratën e vet. Në muajin maj 1920 u mbyll lufta një vjeçare e forcave patriotike të Korçës e rrethinave të saj, duke bashkuar edhe këtë qytet-simbol me qeverinë e Tiranës. Mobilizimi i jashtëzakonshëm popullor bëri që të dështojë edhe këtu, ashtu si në Shkodër, zëvendësimi i trupave franceze me trupat e ushtrisë greke. Jemi në fund të muajit maj. Pas disa ditësh do të fillonte faza e fundit e një epopeje tjetër të nisur gjithashtu një vit më parë, dhe që i ktheu qytetin simbol të Flamurit shtetit shqiptar të rilindur nga vepra dhe heroizmi i bijve të vet.

/gazetashqiptare.al/



E jashtëzakonshme

Çdo vit mori për dhuratë një shishe uiski, djali shet shishet e uiskit për të blerë shtëpi



Babai çdo vit djalit të tij për ditëlindje i ka dhuruar një shishe uiski. Tani djali do ta shesë koleksionin për të blerë një shtëpi. Matthew Robson, nga

Taunton, lindi në vitin 1992 dhe gjatë 28 vjetëve të jetës babai i tij ka shpenzuar 5 000 funta për 28 shishe uiski të maltit në Macallan. Koleksioni tani vlen më

shumë se 40 000 funte dhe Robsoni e ka nxjerrë në shitje. Babai i tij, Pete, tha se shishja e parë e uiskit 1974 ishte blerë për ta "lagur kokën e foshnjës".

BARSOLETA E DITËS



Dy gjakovarë shkojnë me vrap në spital

Mjeku: Çka po vraponi?
Gjakovari: Shoku jem i ka përpirë dy euro.
Mjeku: E ti pse po vrapon pas tij?
Gjakovari: Po paret e mia janë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Njeriu hedh në erë shtëpinë derisa ndiqte mizën

Një burrë në Francë ka hedhur në erë një pjesë të shtëpisë derisa po përpiquej të kapte një mizë. Burri, i cili është rreth moshës 80-vjeçare, gjatë ngrënies së darkës u irritua nga një mizë e cila po gumëzhinte rreth tij. Ai mori një raketë elektrike e cila është krijuar posaçërisht për të vrarë miza, mirëpo një bombol me gaz e cila ndodhej në shtëpinë e tij u gjuajt pa dashur nga raketa. Rrjedhja e gazit shkaktoi një shpërthim, duke shkatërruar kuzhinën dhe dëmtoi pjesërisht çatinë.

FOTO E DITES



Jemi në shtator dhe në Ksamil vazhdon të bëhet plazh



DASHI
Në punë gjithçka do të shkojë

ashtu si e prisnit. Marrëdhëniet shoqërore do të rriten, shtrëngojini duart me njerëzit që kanë rëndësi për ju.



DEMI
Ka një lajm të mirë për ju, një ditë e kënaqshme ju pret. Do të përbaleni me optimizëm, vetëvlerësim dhe do të merni shumë komplimente nga të tjerët.



BINJAKËT
Duhet t'i sqaroni qëllimet tuaja ndaj

personit që qëndron me dashuri pranë jush. Jini të qartë, atëherë do të vendosë lirisht nëse do të vazhdojë me ju apo jo.



GAFORRJA
Ju do të jeni në gjendje ta çlironi

mendjen tuaj, duke e çliruar atë nga zinxhirët e gjykimeve dhe mendimeve të zakonshme të pandryshueshme.



LUANI
Familja është një moment historik në

jetën tuaj dhe ju jeni të vetëdijshëm që gjithmonë mund të mbështeteni në të.



IRGJËRËSHA
Një negociatë që dukej se ishte

ndërprerë do të rihapet. Do të keni plot kuriozitete të reja që do t'ju nxisin të bëni gjëra të cilat më parë nuk keni dashur t'i bëni.



PESHORJA
Ju do t'i kapërceni të gjitha vështirësitë,

nëse mund t'i menaxhoni me shkathtësi edhe ato të papriturat.



AKREPI
Ju do të vazhdoni me qetësi dhe

vendosmëri në rrugën tuaj, duke shmangur njerëzit e paqartë që kthehen rreth jush.



SHIGJETARI
Yjet ju ftojnë të kujdeseni për

shëndetin tuaj, duke filluar me të ushqyerit. Duhet t'u thoni jo ushqimeve pikante, të përpunuara, të skuqura.



BRICJAPI
Do të keni qetësi në sferën

emocionale tek ata që po jetojnë një histori dashurie jo të kënaqshme dhe një vërshim emocionesh të beqarët dhe më të rinjtë.



UJORI
Emocionet dhe ndjenjat nuk janë

në gjendje të përqendrohen në konkretësinë e gjërave, më mirë të presim me kujdes disa ditë.



PESHQIT
Gjatë gjithë kësaj dite do të jeni

e karakterizuar nga ritme shumë të gjalla. Në punën tuaj, përdorni mirë ekstraversionin dhe simpatinë.

Dua, më e dashuruar se kurrë



Prej më shumë se një viti këngëtarja Dua Lipa dhe partneri i saj Anwar Hadid po shijojnë lidhjen e dashurisë dhe janë pjesë e përditshme e shtypit rozë. Dy zogjtë e dashuruar janë bërë thujtë të pandarë nga njëri-tjetri dhe gati në çdo foto të shkrepur vitin e fundit janë sigurisht

së bashku. Madje lidhja e tyre tashmë e konsoliduar vazhdon të bëhet serioze dita-ditës, aq sa Dua vendosi të bëjë një sakrificë të madhe për të dashurin e saj. Këngëtarja shqiptare ka vendosur ta lërë Londrën dhe të zhvendoset në Los Anxhelos. Kjo vetëm për të qenë sa më pranë Anwarit.



Nora dhe Butrinti shfaqen "mbi re"

Një fotosesion fantastik sjellin këngëtarët Nora Istrefi dhe Butrint Imeri. Dyshja e njohur prej kohësh po përfliet për bashkëpunimin e tyre që po sjellin dhe tani gjithçka është e konfirmuar.

Edhe Nora edhe Butrinti kanë postuar disa fotografi ku shihen të shtrirë mbi re dhe të veshur në të bardhë. Ata kanë shkruar se kënga do të publikohet këtë të diel, pa dhënë hollësi të tjera.


Miley Cyrus tregon pse hoqi dorë nga dieta vegane



Miley Cyrus pasi ka ndjekur një dietë të rreptë nga viti 2013 deri në vitin 2019 ka deklaruar se truri nuk po i funksiononte më. Në një rrëfim për "The Joe Rogan Experience", ajo tregoi se ishte ishburri i saj Liam Hemsworth që e shtyu t'i gatonte makaronat e para jovegane. Ajo rrëfen se problemi

ishite mungesa e Omega 3 dhe truri nuk po i përgjigjej siç duhej. "Herë e parë kur Liam gatoi për mua peshk në skarë mbaj mend që qava për orë të tëra. Më vinte keq për peshkun", ka thënë Miley. Më tej, ajo ka thënë se ka hequr dorë, i ha të gjitha dhe ua kujton atyre që i janë kundërvënë, se ka shumë kafshë në fermën e saj.

David dhe Victoria Beckham, të infektuar me koronavirus



Çifti i njohur David dhe Victoria Beckham thuhet se janë infektuar me Covid-19, kur ishin në Los Anxhelos, Kaliforni, në fillim të muajit mars. Sipas mediave britanike, ata kishin frikë se ishin 'super përhapës' pasi, gjithashtu, disa prej stafit të tyre ishin të prekur me koronavirus, pas dy javësh të kaluara me

fëmijët e tyre në botë. Çifti udhëtuan nga Los Anxhelosi për në Mbretërinë e Bashkuar për ta festuar ditëlindjen e 21-të të Brooklynit më 4 mars, para se të ktheheshin në Amerikë më 11 mars. Ndërkohë e gjithë familja u detyrua të karantinohej për një periudhë dyjavore, gjë kjo e përcaktuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KOK-u kërkon nga qeveria lejimin e zhvillimit të aktiviteteve sportive



Komiteti Olimpik i Kosovës ka kërkuar nga qeveria që ta lejojë zhvillimin e aktiviteteve sportive, pasi ndërprerjet e stërvitjeve shkakoi i pandemisë Covid-19 kanë ndikuar në zvogëlimin e numrit të sportistëve, edhe në shuarjen e shumë klubeve

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës ka shqyrtuar me prioritet gjendjen në sportin e Kosovës dhe ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta lejojë zhvillimin e përgatitjeve të klubeve dhe organizimit të aktiviteteve të tjera sportive. Sipas KOK-ut, pandemia Covid-19 ka lënë pasojë të mëdha në sportin e Kosovës, ku është zvogëluar numri i sportistëve dhe klubeve sportive. "Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta lejojë zhvillimin e përgatitjeve për klube dhe organizimin e aktiviteteve të tjera sportive. Ndërprerjet e stërvitjeve shkakoi i pandemisë Covid-19 kanë ndikuar në zvogëlimin e numrit të sportistëve nëpër klube, rrjedhimisht edhe shuarjen e klubeve", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Sipas Komitetit Olimpik, shumë trajnerë të klubeve kanë jetuar vetëm nga zeja e trajnerit dhe ndërprerja e

stërvitjeve ka ndikuar në varfërimin e skajshëm të tyre, andaj kërkohet nga Qeveria e Kosovës që 5 milionë euro të premtuara nga qeveria Kurti për mbështetje të sportit, kulturës e rinisë të ndahen me urgjencë dhe, po ashtu, të trajtohet mundësia që për sport të ndahen mjete financiare shtesë, sepse humbjet në sport, përveç të tjerash, janë të mëdha edhe në aspektin financiar. "U kërkua, po ashtu, nga Qeveria e Kosovës që pesë milionë euro të premtuara nga qeveria Kurti për mbështetje të sportit, kulturës e rinisë të ndahen me urgjencë dhe, po ashtu, të trajtohet mundësia që për sport të ndahen mjete financiare shtesë, sepse humbjet në sport, përveç të tjerash, janë të mëdha edhe në aspektin financiar", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Në mbledhjen e BE të KOK-ut u diskutua edhe për të gjetur një laborator të licencuar ndërkombëtarisht, në të cilin do t'i kryenin testet sportistët e të gjitha sporteve, para pjesëmarrjes në gara

ndërkombëtare.

Drejtuesit e KOK-ut janë të gatshëm që të takohet me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe me personat përkatës vendimmarrës, për ta dhënë kontributin e tyre profesional, në mënyrë që me propozimet e dhëna, ta bëjnë më të lehtë vendimmarrjen nga institucionet përkatëse.

Fillimi i kampionatit në futboll shtyhet për një javë

Pavarësisht se Federata e Futbollit e Kosovës më herët kishte marrë vendim që garat të fillojnë më 12 shtator, kjo nuk do të ndodhë dhe fillimi i kampionatit është shtyrë për një javë. "Kjo gjendje ka vënë në vështirësi edhe aspektin financiar të klubeve, kështu që FFK-ja do të përpiqet që t'i ndihmojë klubet brenda mundësive të veta buxhetore dhe përmes donatorëve të tjerë, në mënyrë që të përballohet sa më lehtë kjo situatë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

SHKURT

Drita transferon Brdarovskin

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e ka transferuar njërin nga lojtarët më të mirë të Vardarit, Vladica Brdarovski. Futbollisti i lindur në Manastir të Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër me klubin gjilanas. Brdarovski për më shumë se pesë vjet ishte pjesë e Vardarit, ku gjatë kësaj periudhe arriti që të shpallej tri herë kampion dhe për shumë sezona barti shiritin e kapitenit, gjithashtu deri në vitin 2015 ishte edhe pjesë e kombëtares së Maqedonisë së Veriut.

Traore mund të ftohet te Kosova

Ylli i skuadrës së Trepça '89, Lassine Traore, është kontaktuar nga Federata e Futbollit e Kosovës. Lajmi është konfirmuar nga vetë futbollisti në një prononcim për "Blic Media". "Jam kontaktuar nga një person i FFK-së i cili më ka pyetur nëse lajmi i publikuar në media është i vërtetë. Ai, gjithashtu, më pyeti nëse jam i gatshëm të bashkohem me Kombëtaren e Kosovës", ka thënë fillimisht Traore, i cili është me prejardhje nga Mali. Ai luan në rolin e mesfushorit, kurse ka bërë paraqitje shumë të mira te '89-shi.

Pllana përforcon 'Niklin'

FC Feronikeli po vazhdon të përforcohet për kampionatin e ri 2020/2021. Talenti Bujar Pllana tash e tutje do të jetë nën udhërrëfues dhe trajnerit Afrim Tovërlani. "Pllana vërehet me elegancën dhe qetësinë e tij në lojë, duke i dhënë një finesë shtesë mbrojtës së FC Feronikelit. Pllana ishte edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U19, i cili ka zhvilluar tri ndeshjet në kualifikimet në Wales. Bujar Pllana më parë ishte pjesë e klubit mitrovicës Trepça '89", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

Federata e Boksit, në pritje të lejes për mbajtjen e turneut 'Lah Nimani'

Federata e Boksit e Kosovës ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e turneut ndërkombëtar "Lah Nimani", i cili do të mbahet më 19-20 shtator në Prishtinë. FboxK-ja ka paraparë që këtë vit turneu të organizohet me boksierë cilësorë të rinj (youth) dhe sendorë (men's) të cilët do të marrin pjesë në kampionatet evropiane U18 në Mal të Zi dhe U22 në Itali muajin nëntor. "FboxK-ja ka bërë kërkesën më 31 gusht në MKRS për lejimin e organizimit të turneut gjithnjë duke respektuar këshillat e dala nga OBSH, MSH dhe IKShPK. Besojmë dhe shpresojmë se do ta marrim lejen dhe t'i vazhdojmë aktivitetet sipas kalendarit të garave të dala nga Federata Evropiane EUBC dhe Federata Botërore AIBA", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit të Kosovës.

Bekaj: Përmes Tiranës do të kaloj në një klub evropian

TIRANË, 9 SHTATOR - Portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Visar Bekaj, javë më parë u largua nga Prishtina për të nënshkruar me Tiranën. Në një intervistë për "Panorama Sport", gardiani më i ri i bardhebluve ka folur për të ardhmen dhe sigurisht aventurën që do të kalojë me kampionin e Shqipërisë. "Besoj

se nuk ishte zgjedhje e vështirë. Ishte një zgjedhje e lehtë për të zgjedhur një klub si Tirana që është kampione. Siç e kam thënë, ngjyrat nuk i kam ndër-ruar, por vetëm jam në një vend tjetër. Kam ndërruar edhe kryeqytet. Të gjithë e dinë cila është Tirana, klubi më i madh në shqiptari. Thjesht kam

zgjedhur më të mirën. Jam i bindur që do të bëjmë më të mirën, ka për të na ecur mirë dhe do të bëhemi kampione", ka thënë Bekaj. "Në Shqipëri kam ardhur për një trampolinë të madhe, për një klub të madh të shqiptarisë. Shpresoj se ky sezon të ecë mirë dhe të shpallemi kampione. Tirana

nuk do të jetë trampolinë vetëm për të ardhmen në klube. Besoj se do të më ndihmojë që të arrij edhe kombëtaren e Kosovës ose, më saktë, formacionin titullar. Sigurisht, kjo vjen me paraqitje të mira. Jam i bindur se do të na ecë mirë si këtu dhe në kombëtare", ka shtruar Bekaj.



VISAR BEKAJ

Sonte nënshkruhet marrëveshja historike për themelimin e Ligës Unike

PRISHTINË, 9 SHTATOR - Sonte (e enjte) nga ora 19:00 në Tiranë do të nënshkruhet marrëveshja historike ndërmjet Federatës Shqiptare të Basketbollit (FShB) dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për themelimin e Ligës së Basketbollit mes dy shteteve, që do të quhet "Liga Unike". Marrëveshjen do ta nënshkruajnë presidenti i FShB-së, Avni Ponari, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, në praninë e Besa Shahini, ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri dhe Vlora Dumoshi, ministre për Kulturë, Rini dhe Sport e Kosovës. I pranishëm në këtë ceremoni do të jetë edhe kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, i cili do ta zbulojë edhe logon e Ligës Unike. "Pas një pune të gjatë dhe intensive mes dy federatave, më në fund po jetësohet ëndrra për zhvillimin e veprimtarive basketbollistike të trevave shqiptare. Në Ligën Unike do të marrin pjesë tetë skuadra, katër më të mirat nga Kosova dhe katër më të mirat nga Shqipëria. Liga Unike pritet të fillojë së



shpejti, gjatë këtij edicioni sportiv dhe parashikohet të jetë shumë interesante, duke zgjuar interesimin e tifozëve shqiptarë, kurse në parket pritet të ketë shumë rivalitet mes skuadrave që do të përfshihen në këtë kompeticion", thuhet FBK-së. Bordi Drejtues i Ligës Unike që përbëhet nga dy anëtarë të Bordeve të FShB-së dhe FBK-së, si dhe nga dy sekretarët e përgjithshëm të të dyja federatave, do ta mbajë

mbledhjen e parë, ku do të emërojnë edhe kryetarin e Bordit Drejtues e do ta emërojnë stafin e zyrës së Ligës Unike. Duhet theksuar se ky është një hap i madh për basketbollin në hapësirat shqiptare duke formuar Ligën Unike. Ky projekt është përkrahur nga komuniteti i basketbollit në Shqipëri dhe Kosovë, duke e konsideruar atë si një ngjarje të shumëpritur dhe është përkrahur edhe nga FIBA Evropa.

Miami kualifikohet në finalen e Lindjes

ORLANDO, 9 SHTATOR - Miami është skuadra e parë finaliste e "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, pasi arriti fitore me rezultat 103-94 ndaj Milwaukee, duke fituar në këtë mënyrë 4-1 serinë e gjysmëfinaleve. Ky ishte padyshim një rezultat surprizë, pasi Milwaukee ishte skuadra me rekordin më të mirë të sezonit të rregullt dhe favorite për titull. Gjithsesi, mungesa e MVP, Giannis Antetokounmpo, ndikoi



në këtë sfidë dhe ato të mëparshmet, ku luajti i dëmtuar. Për Bucks u dallua Middleton me 23 pikë, por të pamjaftueshme për ta evituar humbjen. Për Miami, Butler e Dragiq realizuan nga 17 pikë, ndërkohë që 38 pikë erdhën nga lojtarët rezervë. Në Perëndim, skuadra e Lakersave fitoi me rezultat 112-102 ndaj Houstonit,

duke udhëhequr 2-1 serinë e gjysmëfinaleve. Ndeshje me rivalitet për 3 perioda, por në të fundit skuadra e Lakersave bëri diferencën në parket me LeBron Jamesin (36 pikë) e Anthony Davisit (26 pikë e 15 rebounde), duke i bërë të pavlefshme 63 pikët e dyshes Harden-Westbrook për teksanët.

SHKURT

Dy lojtarë pozitivë me Covid-19 te Bullgaria

Raste të reja me koronavirus në ekipet kombëtare të futbollit. Bullgaria u mposht 1-0 jashtë fushës kundër Uellsit, që siguroi tri pikët falë golit të Neco Williamsit në minutën e katërt shtesë. Lojtarët bullgarë u janë nënshtruar tamponëve dhe përgjigjet kanë rezultuar pozitive për dy futbollistët. Spas Delev dhe Peter Zanev janë lojtarët e infektuar me Covid-19. Të dy futbollistët kanë shfaqur disa simptoma dhe testet i kanë nxjerrë pozitivë, teksa kanë nisur menjëherë karantinën.

Bayerni e konsideron të panevojshëm Perisiçin, kroati rikthehet tek Interi

Trajneri i Bayern Munchenit, Hansi Flick, ka vendosur që të mos e blejë përfundimisht kartonin e Ivan Perisiçit. Kroati u huazua nga Interi te "bavarezët" për 5 milionë euro me opsion për ta blerë përfundimisht për 20 milionë euro të tjera. Ky opsion nuk është përdorur nga Bayerni, pasi ekipi gjerman ka kërkuar një ulje të çmimit, por zikaltrit nuk kanë pranuar. "Ne kemi vendosur të mos vazhdojmë me Odriozolën, Coutinhon dhe Perisiçin. Për sa kohë që Alaba dhe Thiago të jenë këtu, do t'i konsideroj në dispozicionin tim", ka thënë Flick për "Abdenzeitung". Perisiç bëri 35 paraqitje me Bajernin, ku fitoi kampionatin Kupën e Gjermanisë dhe Ligën e Kampioneve.

Rossi do të tërhiqet nga MotoGP

Lajmi vjen nga Gjermania dhe, nëse konfirmohet, do të ishte i destinuar të krijonte një tërmet të vërtetë në MotoGP. Sipas portalit "Speedweek", Valentino Rossi është gati të tërhiqet përfundimisht, duke lënë kështu një vend të lirë në ekipin Yamaha Petronas për Botërorin e vitit 2021. Në vend të tij, mbi M1 të ekipit malajzian do të hipte Andrea Dovizioso, i cili në muajt e fundit kishte njoftuar mosmarrëveshjen me Ducatin për rinovimin e kontratës së tij. Lajmi, natyrisht, duhet të merret me rezervë. Në fakt, fjalët e fundit të Valentinos për të ardhmen e tij ishin mjaft të qarta: "Unë do të qëndroj te Yamaha me 99 %".

Është e vërtetë, "Doktori" nuk ka hedhur të zezën mbi të bardhë. Nënshkrimi i kontratës po vonon, por kohët e fundit shefi i Yamahas, Lin Jarvis, specifikoi se është çështje burokratike: "Nuk ka asnjë problem. Megjithatë, ka disa aspekte që duhet të merren parasysh në negociatat që po kryejmë. Yamaha e ka ekipin e vet ligjor në Japoni, Petronas në Malajzi dhe piloti në Itali. Ne duhet t'i bashkojmë të gjitha palët dhe situata që po përjetojmë në një shkallë globale e bën të vështirë që njerëzit të mund të takohen fizikisht". Mund të ndodhë që gjatë fundjavës, në Misano, Vale mund të heqë çdo dyshim. Është garë "e tij", konteksti më i mirë për një njoftim të madh, qoftë një lamtumirë.

PSG-ja e nis kampionatin me 8 mungesa

Paris Saint Germain do ta fillojë me 8 mungesa sezonin e ri të Ligës 1, ku 7 prej tyre janë titullarë. Kampionët e Francës të cilët do të zbrisin në fushë të enjten e 10 shtatorit për ndeshjen e javës së 2-të ndaj Lensit në program për t'u luajtur në fund të gushtit, por që u shty me kërkesën e PSG-së, nuk do të kenë në dispozicion emra të rëndësishëm për shkak se plot tetë futbollistë janë prekur nga Covid-19 dhe duhet të qëndrojnë në karantinë. Në këtë listë bëjnë pjesë dy portierët Keylor Navas e Sergio Rico, por edhe treshja e frikshme sulmuese Neymar-Icardi-Mbappe, ndërsa të prekur me koronavirus janë edhe Di Maria, Paredes e Marquinhos.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 219/1
 Dt:09.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Malishevë për vitin shkollor 2020/2021

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndët Ekonomike me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një(1) mësimdhënës /e për profilin e TIK me 10 orë mësimore;	Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysnë, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA –SUHAREKË
 OPŠTINE SUVA REKA
 THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr .1358
Me datë: 08.09.2020

Në bazë të nenit 8-të paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr- 03/L-212, nenit 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ(MPMS)nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kërkesën nr.792 të datës 18.08.2020 të QKMF-së Suharekë dhe Autorizimit të Kryetarit të Komunës,01-Nr.016-41169 të datës 02.09..2020, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall:

KONKURS
Për :

1 (një) Vozitës në shërbimin teknik në QKMF-në në Suharekë
 Grada/koefficienti: H-84
 Lloji i emërimit: I KARRIERES
 Kohëzgjatja: Zbatohet periudha provuese prej 6 muaj me mundësi vazhdimi
 Orari plotë: 40 orë në javë

Detyrat dhe përgjegjësit:

Bën Kontrollimin e Autoambulancës dhe përgatit atë për çdo rast kur duhet të ndërvejoj mjeku në teren apo në qendrat me të mëdha si në Prishtinë. Për çdo ditë mbanë evidencën e kilometrazhës së kaluar dhe në fund të orarit ja dorëzon mjekut të ambulancës . Po ashtu është i obliguar që të vozitë ekipin mjekësor për kontroll në teren si nëpër shkollat dhe fshatrat e Komunës. Kryen punët tjera nga fushë-veprimtaria e ndihmës së shpejtë dhe punët që urdhërohen nga Mjeku i qendrës.

Kushtet për punësim:

- Përgatitje shkollore;
 - Përvoja e punës 1(një)vit;
 - Të Ketë Patentë shoferin Kategorji B
 - Të njohë gjuhët zyrtare (shqip,serbisht);
 - Trajnimet(të dëshiruara);
 - Shkathtësi dhe aftësi personale për të punuar në shoqëri multietnike.
- Çdo kandidat (aplikues)për pozitat e lartëcekura duhet të kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin me sa vijon:**
- Ta plotëson aplikacionin
 - Dokumentacionin mbi përgatitjen dhe kualifikimin profesional Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komuna Suharekë.

Të gjithë kandidatët që do të hynë në listën e ngushtë, për datën e mbajtjes së intervistës do të njoftohen me kohë dhe do të intervistohen nga komisioni intervistes.



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Shaqir Mala -Shef



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA –SUHAREKË
 OPŠTINE SUVA REKA
 THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
06-Nr . 1358
Datum: 08.09.2020

Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br.07 / 2017 o uređivanju postupaka Konkursa u javnom sektoru, Zahtev br.792 dana: 18.08.2020 OCPZ – Suva Reka i ovlašćenja Predsednika Opštine, 01-Br.016-41169 od 02.09.2020, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:

KONKURS
Za :

1 (jedan) Vozaç u OCPZ - u Suvoj Rijeci
 Količina / koeficijent: **H-84**
 Vrsta sastanka: **KARIERA**
 Trajanje: Probni rod od 6 mjeseci, s mogućnošću produžavanja.
 Puno radno vrijeme: 40 sati sedmično

Obaveze i odgovornosti:

Provjerava auto hitne pomoći i priprema je za svaki slučaj kad lekar mora da interveniše na terenu ili u većim centrima kao u Prištini. Svakog dana vodi evidenciju o posljednjem kilometru, a na kraju rasporeda predaje je lekar na pomoć. Takođe je dužan voziti medicinsku ekipu na kontrolu na teren, kako u školama, takođe i u selima Općine. Obavlja i druge zadatke i oblasti hitne pomoći i zadatke koje odredi centralni lekar

Uslovi za zapošljavanje:

- Priprema škole;
- Radno Iskustvo 1 (jedna) godina;
- Treba imati B kategorija vozačke dozvole .
- Treba znati službene jezike (albanski i srpski);
- Obuka (željena);
- Veštine ili opremu za trajni rad u multietničkom društvu;

Svaki kandidat (kand) za gore navedena mjesta mora ispuniti i predati sljedeću dokumentaciju:

- Popuniti aplikaciju
- Dokumentacija o profesionalnom usavršavanju kvalifikaciji

Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu u Opštini Suva Reka

Svi kandidati koji budu u užu izboru za datum intervjuja biće pravo vreme obavešteni.



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit
Shaqir Mala - Šef



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës

Nr. i Prokurimit 08-20

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **17.09.2020 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **21.09.2020 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **21.09.2020 ora 14:00.**



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 07.09.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 10.09.2020 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës:

1(një) Punëtor Fizik -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë shkollën fillore ose së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muajt)

Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 10.09.2020 deri më datën 24.09.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Swiss point CH", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811184514, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Swiss point CH" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811184514, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Swiss point CH" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811184514, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► "DP LUX" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71356590.

► Lëshoj banesë me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxe-hje qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

